



BANKA QENDRORE E REPUBLIKES SË KOSOVËS
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

RAPORTI I ZHVILLIMEVE MAKROEKONOMIKE

Numër | 1
Shtator | **2014**

BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

Raporti i Zhvillimeve Makroekonomike

Numër 1

BOTUES Banka Qendrore e Republikës së Kosovës ©
Departamenti i Stabilitetit Financiar dhe Analizave Ekonomike
33 Garibaldi, Prishtinë 10000
Tel: ++381 38 222 243
Fax: ++381 38 243 763

FAQJA E INTERNETIT www.bqk-kos.org

ADRESA ELEKTRONIKE economicanalysis@bqk-kos.org;

KRYEREDAKTOR Arben MUSTAFA

REDAKTOR Sokol HAVOLLI

AUTORË Zana GJOCAJ
Bejtush KIÇMARI

REDAKTOR TEKNIK Butrint BOJAJ

SHTOJCA STATISTIKORE: Departamenti i Statistikave

VËREJTJE: Përdoruesit e këtyre të dhënave kërkohen të citojnë burimin.
Citimi i sugjeruar: Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (2014),
Raporti i Zhvillimeve Makroekonomike Nr. 1, Prishtinë.
Çdo korigjim i nevojshëm bëhet në versionin elektronik.

SHKURTESAT

ALL	Leku Shqiptar (<i>angl: Albanian Lek</i>)
ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
BE	Bashkimi Evropian
BQE	Banka Qendrore Evropiane
BQK	Banka Qendrore e Republikës së Kosovës
CEFTA	Marrëveshja e Tregtisë së Lirë me Shtetet e Evropës Juglindore (<i>angl: Central European Free Trade Agreement</i>)
CHF	Franku Zvicerran (<i>angl: Swiss Frank</i>)
CPI	Indeksi i Çmimeve të Konsumatorit (<i>angl: Consumer Price Index</i>)
EJL	Evropa Juglindore
EULEX	Misioni i Bashkimit Evropian mbi Sundimin e Ligjit (<i>angl: European Union Rule of Law Mission</i>)
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar
GBP	Poundi Britanik (<i>angl: Great Britain Pound</i>)
HRK	Kuna Kroate (<i>hrv: Hrvatska Kuna</i>)
IHD	Investimet e Huaja Direkte
IPI	Indeksi i Çmimeve të Importit (<i>angl: Import Price Index</i>)
KFOR	Forca Ushtarake e NATO-së në Kosovë (<i>angl: NATO-led Kosovo Force</i>)
MKD	Denari Maqedon (<i>angl: Macedonian Denar</i>)
PBB	Produkti i Brendshëm Bruto
PPI	Indeksi i Çmimeve të Prodhimit (<i>angl: Producer Price Index</i>)
REER	Norma Reale Efektive e Këmbimit (<i>angl: Real Effective Exchange Rate</i>)
RSD	Dinari Serb (<i>angl: Serbian Dinar</i>)

SIMBOLET KONVENCIONALE

"—"	dukuria nuk ekziston
". "	dukuria ekziston, të dhënat nuk janë në dispozicion
"..."	zero ose afër zeros
(e)	e vlerësuar
(p)	preliminare
(r)	e reviduar

PËRMBAJTJA

Fjala e Guvernatorit	9
1. Përmbledhje Ekzekutive	13
2. Ekonomia globale dhe eurozona	15
3. Evropa Juglindore	19
3.1. Çmimet e mallrave kryesore në tregjet ndërkombëtare	21
3.1.1 Çmimet e arit	22
3.1.2 Çmimet e metaleve tjera	22
3.1.3 Çmimet e prodhimeve ushqimore	23
4. Përmbledhje e zhvillimeve të përgjithshme makroekonomike në Kosovë	24
4.1. Produkti i brendshëm bruto	25
4.2. Sektori i Ndërmarrjeve	26
4.3 Çmimet	27
4.3.1 Struktura e inflacionit dhe inflacioni bazë	27
4.3.2 Çmimet e importit dhe prodhimit	29
4.3.3 Çmimet e Patundshmërisë	30
4.3.4. Sektori i jashtëm	31
4.4.2 Llogaria financiare	36
4.4.3 Pozicioni ndërkombëtar i investimeve	38
4.4.4 Borxhi i jashtëm	39
4.4.5 Sektori fiskal	40
4.4.6 Sistemi Financiar	43
5. Pritjet e bankave mbi aktivitetin kreditor	46
6. Parashikimet mbi treguesit kryesor makroekonomik	47
6.2. Sektori bankar	49
6.3. Sektori fiskal	50
6.3.1 Të hyrat buxhetore	50
6.3.2 Shpenzimet buxhetore	50
6.3.3 Financimi	50
6.4. Sektori i jashtëm	51
7. Shtojca statistikore	53
8. Referencat	73

LISTA E FIGURAVE

Figura 1. Rritja reale e PBB-së-----	15
Figura 2. Klima e biznesit në Gjermani dhe rritja ekonomike -----	15
Figura 3. Papunësia -----	15
Figura 4. Inflacioni vjetorë -----	15
Figura 5. Llogaria rrjedhëse si pjesëmarrje e PBB-së -----	18
Figura 6. Norma e rritjes së PBB-së reale në EJL-----	19
Figura 7. Norma mesatare vjetore e inflacionit në EJL-----	19
Figura 8. Deficiti i llogarisë rrjedhëse në EJL-----	20
Figura 9. Norma e kredive jo performuese -----	21
Figura 10. Çmimi i naftës “brent crude” -----	21
Figura 11. Çmimi i arit për ounce -----	21
Figura 12. Çmimet e metaleve -----	22
Figura 13. Gjithsej eksportet dhe çmimet ndërkombëtare të metaleve-----	23
Figura 14. Indeksi i çmimeve të ushqimit -----	23
Figura 15. Indeksi i kombinuar mbi ndikimin sektorial në aktivitetin ekonomik -----	24
Figura 16. Indeksi i kombinuar mbi ndikimin sektorial në rrezikun ekonomik-----	24
Figura 17. Rritja reale e PBB-së në Kosovë -----	25
Figura 18. PBB-ja dhe komponentët kryesorë të saj-----	25
Figura 19. Regjistri i bizneseve -----	26
Figura 20. Struktura e ndërmarrjeve të reja-----	26
Figura 21. Vlerësimi i bizneseve për situatë biznesore në tremujt e kaluar -----	26
Figura 22. Inflacioni dhe kontribuuesit kryesor të tij-----	27
Figura 23. Çmimet e ushqimit dhe kategoritë kryesore të tij -----	27
Figura 24. Çmimet e strehimit, ujit dhe energjisë -----	27
Figura 25. Çmimet e shërbimeve -----	28
Figura 26. Inflacioni i përgjithshëm dhe inflacioni bazë -----	28
Figura 27. Indekset e çmimeve të konsumit -----	29
Figura 28. Mesatarja e thjeshtë e çmimeve të listuara për apartamente në Prishtinë -----	30
Figura 29. Financimi i patundshmërisë nga sistemi bankar dhe investimet e huaja direkte -----	30
Figura 30. Pritjet e bankave mbi kërkesën për kreditë nga ndërmarrjet -----	31
Figura 31. Bilanci i llogarisë rrjedhëse -----	31
Figura 32. Importet, eksportet dhe bilanci tregtar-----	32
Figura 33. Gjithsej eksportet dhe çmimet ndërkombëtare të metaleve-----	32
Figura 34. Gjithsej importet dhe çmimet ndërkombëtare të naftës dhe ushqimit -----	32
Figura 35. Struktura e eksporteve dhe importeve sipas shteteve -----	33

Figura 36. Struktura e neto eksportit të shërbimeve -----	33
Figura 37. Transferet rrjedhëse -----	35
Figura 38. Pranimet e remitencave -----	35
Figura 39. Investimet e huaja direkte -----	37
Figura 40. Investimet e huaja direkte sipas sektorëve kryesor ekonomik -----	37
Figura 41. Pozicioni ndërkombëtar i investimeve -----	38
Figura 42. Pozicioni ndërkombëtar i investimeve neto sipas sektorëve institucional -----	39
Figura 43. Borxhi i jashtëm bruto -----	39
Figura 44. Borxhi i jashtëm bruto sipas sektorëve -----	40
Figura 45. Të hyrat dhe shpenzimet buxhetore -----	40
Figura 46. Struktura e të hyrave buxhetore -----	41
Figura 47. Të hyrat kufitare neto sipas llojeve të tatimeve -----	41
Figura 48. Struktura e shpenzimeve buxhetore -----	42
Figura 49. Peshja e sektorit bankar në ndërmjetësim -----	42
Figura 50. Norma e rritjes së kredive sipas sektorëve -----	43
Figura 51. Trendi i rritjes së kredive sipas sektorëve ekonomik -----	43
Figura 52. Mesatarja vjetore e normave të interesit -----	43
Figura 53. Mesatarja vjetore e normave të interesit -----	44
Figura 54. Treguesit e profitabilitetit -----	44
Figura 55. NPL-të dhe provizionet -----	45
Figura 56. Pritjet e bankave mbi kërkesën për kredi nga ndërmarrjet -----	46
Figura 57. Pritjet e bankave mbi kërkesën për kredi për kredi konsumuese dhe hipotekare -----	46
Figura 58. Rritja reale e PBB-së, kërkesa e brendshme dhe e jashtme -----	49
Figura 59. Rritja reale e PBB-së dhe kontribuesit kryesor në rritje -----	49
Figura 60. Rritja e kreditimit dhe rritja reale e PBB-së -----	50
Figura 61. Rritja e kreditimit dhe rritja reale e PBB-së -----	50
Figura 62. Të hyrat dhe shpenzimet primare buxhetore -----	51
Figura 63. Llogaria rrjedhëse -----	52
Figura 64. Eksporti dhe importi i mallrave -----	52

LISTA E TABELAVE

Tabela 1. Norma e rritjes së kredive dhe depozitave ne vendet e EJL-së -----	20
Tabela 2. Ndarja e IÇK-së -----	29
Tabela 3. Llogaria financiare -----	36

Fjala e Guvernatorit

Aktiviteti ekonomik në Kosovë gjatë vitit 2013 u zhvillua në një ambient më të favorshëm makroekonomik. Rikuperimi në eurozonë ishte më i theksuar në ekonomitë kryesore të kësaj bashkësie, ndaj të cilave ekonomia e Kosovës është më e ekspozuar, ndërsa vendet më periferike u karakterizuan me zhvillime më pak të favorshme. Politikat stimuluuese monetare që ndërmori BQE gjatë vitit 2013 për të nxitur rritjen e kërkesës së brendshme dhe evituar presionet e ulëta inflacioniste ndikuan në përmirësimin e ritmit të rritjes së aktivitetit ekonomik në eurozonë, megjithëse kërkesa e jashtme mbeti e dobët si pasojë e recesionit të vazhdueshëm në disa nga ekonomitë evropiane si dhe nga rritja ende e ngadalshme e ekonomisë globale.

Zhvillimet më të favorshme në vendet kryesore të eurozonës dhe në EJT u reflektuan edhe në ekonominë e Kosovës, ku në vitin 2013 aktiviteti ekonomike vlerësohet të ketë shënuar rritje reale prej 3.4 përqind, normë kjo më e lartë se ajo e shënuar në vitin paraprak. Rritja e aktivitetit ekonomik gjatë vitit 2013 vlerësohet të jetë mbështetur kryesisht nga rritja e konsumit të përgjithshëm, dhe rënia e deficitit në komponentën e neto eksporteve. Ndërsa investimet në krahasim me vitin paraprak, kishin kontribut po thuaj se neutral. Remitencat dhe kreditë konsumuese ishin faktorët kryesor që financuan rritjen e konsumit gjatë vitit 2013, ndërsa rënia e importit dhe rritja e eksportit zvogëluan deficitin duke kontribuar pozitivisht në rritje. Presionet e ulëta inflacioniste në vendet e eurozonës, rajon ky më të cilin Kosova realizon pjesën më të madhe të shkëmbimeve tregtare, u reflektuan edhe në ekonominë e vendit duke rezultuar në zvogëlim të konsiderueshëm të normës së inflacionit.

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës mbetet e përkushtuar në arritjen dhe ruajtjen e stabilitetit financiar dhe makroekonomik në vend, dhe në funksion të këtij objekti është edhe publikimi i këtij raporti që ofron një pasqyrë të vlerësimit të zhvillimeve në të gjithë sektorët e ekonomisë. Në këtë kontekst, gjatë vitit 2014, në bashkpunim me FMN-në, BQK avancoi modelin për projeksione makroekonomike dhe tani në baza të rregullta kohore do të paraqes parashikimet e saja mbi pritjet për aktivitetin ekonomik në vend. Për vitin 2014, bazuar në këtë model, parashikimet e BQK-së sugjerojnë se norma reale e rritjes ekonomike pritet të përshpejtohet në krahasim me vitin 2013, duke arritur në 3.7 përqind. Ky përshpejtim i rritjes pritet të mbështetet nga rritja e konsumit privat, ndërsa ndikim pozitiv pritet të ketë edhe konsumi publik. Sa i përket investimeve, kontributi i tyre pritet të jetë po thuaj se neutral, pasi që investimet publike për vitin 2014 pritet të performojnë negativisht. Megjithatë, investimet private pritet të rriten mjaftueshëm sa për të eliminuar kontributin negativ të investimeve publike. Investimet private gjatë vitit 2014 pritet të përkrahen në masë më të madhe nga sektori bankar vendor i cili ka përshpejtuar normën e rritjes së kreditimit në krahasim me vitin paraprak.

Gjatë vitit 2014, sektori fiskal parashihet të karakterizohet me rritje të të hyrave dhe shpenzimeve buxhetore. Sidoqoftë, rritja e shpenzimeve pritet të jetë më e lartë duke bërë kështu që edhe deficitin primar të rritet në krahasim me vitin paraprak. Sektori i jashtëm pritet të karakterizohet me rritje të deficitit të llogarisë rrjedhëse, si pasojë e përkeqësimit të lehtë të pozicionit tregtar në mallra dhe shërbime. Sa i përket çmimeve, parashikimet sugjerojnë se norma e inflacionit do të zvogëlohet edhe më tutje, duke arritur në rreth 1 përqind, i nxitur nga trendi rënës i çmimeve të produkteve kryesore në nivel global, sidomos atyre që Kosova importon më shumë si nafta dhe produktet ushqimore.

Në përgjithësi, mund të konsiderohet se ekonomia e Kosovës ka vazhduar të ruaj stabilitetin makroekonomik, duke vazhduar të rritet në mënyrë graduale, ndërsa për vitin 2014 pritet që ritmi i rritjes ekonomike të përshpejtohet edhe më tutje. Megjithatë, zhvillimet ekonomike nëpër

të cilat po kalon ekonomia globale, përkundër rikuperimeve të kohëpaskohshme, vazhdojnë të paraqesin shqetësim për ekonominë e rajonit tonë. Si pasojë, performanca e përgjithshme ekonomike në rajon mund të konsiderohet ende e brishtë. Rrjedhimisht, arritja e normave më të larta të rritjes ekonomike, të domosdoshme për të adresuar problemet kryesore të ekonomive të rajonit tonë, paraqitet të jetë mjaft sfiduese.

Bedri HAMZA

Guvernator

1. Përmbledhje Ekzekutive

Zhvillimet ekonomike globale në vitin 2013 janë përmirësuar dhe ekonomia botërore pritet të vazhdojë rikuperimin e saj gradual të rritjes ekonomike edhe në vitin 2014. Në vitin 2013, rikuperimi i rritjes ekonomike ishte me i theksuar në vendet e zhvilluara si SHBA-të, Japonia, Mbretëria e Bashkuar dhe disa nga vendet më të zhvilluara të eurozonës si Gjermania dhe Franca. Vendet në zhvillim si India, Indonezia dhe Brazili, megjithëse vazhdojnë të kenë normë të lartë të rritjes dhe peshë të madhe në rritjen ekonomike globale, në vitin 2013 janë karakterizuar me ritëm më të ngadalshëm të rritjes. Ekonomia e eurozonës u ballafaqua për të dytin vit me radhë me recesion. Në kuadër të vendeve të eurozonës është vënë re një dallim në ritmin pozitiv me të cilin po rikuperohej ekonomitë kryesore sikurse Gjermania dhe Franca krahasuar me ngecjet në ekonomitë më periferike. Përkundër karakterit stimulues të politikës monetare që mirëmbajti BQE gjatë vitit 2013 për të nxitur rritjen e kreditimit, rrjedhimisht konsumit dhe investimeve, kreditimi në eurozonë mbetet i shtrënguar. Vendet e rajonit u karakterizuan me përmirësim të aktivitetit ekonomik, që kryesisht i atribuohet rritjes së eksporteve dhe deri diku edhe rritjes së investimeve të huaja direkte.

Zhvillimet e favorshme në vendet kryesore të eurozonës dhe në EJT u reflektuan edhe në ekonominë e Kosovës, ku në vitin 2013 rritja ekonomike ishte më e lartë se sa në vitin paraprak. Ekonomia e Kosovës shënoi normën relativisht të lartë të rritjes ekonomike në vitin 2013 që arriti në 3.4 përqind. Aktiviteti ekonomik në vend gjatë vitit 2013 u mbështet nga rritja e konsumit dhe përmirësimi i pozicionit të neto eksporteve, përderisa investimet mbeten me efekt po thuaj se neutral. Rritja e konsumit i atribuohet kryesisht rritjes së remitencave dhe kredive konsumuese gjatë kësaj periudhe, si dhe rritjes së shpenzimeve rrjedhëse të qeverisë. Komponenta e investimeve në vitin 2013 u karakterizua pozicion të ngjashëm me vitin paraprak. Në të njëjtën periudhë, rritja e eksporteve dhe rënia e importeve gjatë vitit 2013 rezultoi në zvogëlim të deficitit tregtar në mallra, duke e bërë që pozicioni i neto eksporteve të përmirësohet dhe të kontribuojë lehtë pozitivisht në rritje.

Presionet deflacioniste në vendet e eurozonës, rajon ky më të cilin Kosova realizon pjesën më të madhe të shkëmbimeve tregtare, u reflektuan edhe në ekonominë e vendit. Në vitin 2013, ekonomia e Kosovës përfitoi nga rënia e çmimeve të produkteve të importuara, në veçanti rënies së çmimeve të derivateve të naftës, të cilat gjithashtu kanë ndikuar edhe koston e prodhimit në vend. Norma mesatare vjetore e inflacionit në vitin 2013 ishte 1.8 përqind, krahasuar me normën prej 2.5 përqind të shënuar në vitin 2012. Zhvillimet në nivelin e çmimeve në vend vazhdojnë të përcaktohen nga lëvizja e çmimeve në tregjet ndërkombëtare si pasojë e varësisë së lartë të ekonomisë së vendit në importe, gjë që konfirmohet edhe me sjelljen e ngjashme të indeksit të çmimeve të konsumit me indeksin e çmimeve të importit. Në të njëjtën kohë, vendet në rajon u përballën me çmime më të larta krahasuar me Kosovën, duke ndikuar kështu që produktet vendore të jenë më konkurruese ndaj produkteve të vendeve të rajonit.

Raporti i deficitit të llogarisë rrjedhëse ndaj PBB-së në vitin 2013 ishte 6.4 përqind në vitin 2013 (7.5 përqind të PBB-së në vitin 2012), që paraqet nivelin më të ulët të shënuar që nga viti 2007. Rënia e deficitit në llogarinë rrjedhëse ishte kryesisht rezultat i zvogëlimit të deficitit tregtar, gjegjësisht rritjes së eksporteve dhe zvogëlimit të importeve. Rritja e eksporteve të vendit është mbështetur kryesisht nga rritja e kërkesës së jashtme në vitin 2013, sidomos në vendet e eurozonës dhe vendet e rajonit, si dhe nga rritja e çmimeve të metaleve bazë në tregjet ndërkombëtare. Në të njëjtën kohë, importet janë karakterizuar me rënie që deri në një masë mund ti atribuohet zëvendësimit të një pjese të mallrave të importit me prodhim vendor, si dhe rënies së çmimeve të produkteve kryesore që importohen në Kosovë. Në kuadër të bilancit të

pagesave në Kosovë, transferet rrjedhëse vazhdojnë të përfaqësojnë një kategori me rëndësi të veçantë në kontekst të zvogëlimit të deficitit të llogarisë rrjedhëse. Në kuadër të transfereve rrjedhëse, remitencat arritën vlerën prej 620.8 milionë euro në vitin 2013, që paraqet një rritje vjetore prej 2.5 përqind.

Llogaria financiare në kuadër të bilancit të pagesave vazhdon të dominohet nga kategoria e investimeve të huaja direkte (IHD). Investimet e huaja direkte në vend dhe investimet direkte të rezidentëve Kosovar jashtë vendit u karakterizuan me rritje në vitin 2013. Përmirësimi i trendit të rritjes së IHD-ve në Kosovë në vitin 2013 paraqet një zhvillim shumë të rëndësishëm për qëndrueshmërinë e financimit të deficitit të llogarisë rrjedhëse. Në vitin 2013, IHD-të në Kosovë shënuan një rritje vjetore prej 13.5 përqind, duke arritur vlerën prej 259.4 milionë euro.

Gjatë vitit 2013, sektori fiskal i ekonomisë së vendit u karakterizua me rënie të lehtë të të hyrave dhe rritje të shpenzimeve. Buxheti i Kosovës regjistroi deficit primar prej 152.7 milionë euro, gjegjësisht 2.9 përqind të PBB-së krahasuar me 2.4 përqind të PBB-së sa ishte në vitin paraprak. Në të njëjtën periudhë, borxhi i përgjithshëm i qeverisë arriti në 475.7 milionë euro apo 9.1 përqind e PBB-së (8.4 përqind në vitin 2012). Kosova vijon të ketë nivelin më të ulët të deficitit primar dhe poashtu nivelin më të ulët të borxhit publik krahasuar me vendet e rajonit.

Viti 2013 ishte i favorshëm edhe për sa i përket zhvillimeve në sektorin bankar. Vlera e gjithsej kredive në vitin 2013 arriti në 1.81 miliard euro, që paraqet një rritje vjetore prej 2.4 përqind. Gjatë vitit 2013, normat mesatare të interesit në kredi ishin 12.4 përqind (13.4 përqind në vitin 2012) përderisa normat mesatare në depozita ishin 3.4 përqind (3.6 përqind në vitin paraprak). Depozitat mbeten burimi kryesor i financimit për bankat, që në vitin 2013 arritën vlerën prej 2.45 miliard euro, një rritje vjetore prej 7.5 përqind. Stabiliteti i sektorit bankar mbetet një kontribuues i rëndësishëm në ruajtjen e stabilitetit të përgjithshëm makroekonomik. Treguesit kyç të likuiditetit u karakterizuan me rritje, duke ndikuar në përmirësimin e pozitës së likuiditetit të sektorit bankar. Gjithashtu, sektori bankar është karakterizuar në vazhdimësi me nivel të lartë të kapitalizimit i cili ka kaluar kërkesat minimale rregullative. Gjatë vitit 2013, ekspozimi ndaj rrezikut kreditor është rritur, ku raporti i Kredive Joperformuese ndaj gjithsej kredive në dhjetor 2013 arriti në 8.7 përqind (7.5 përqind në 2012). Sidoqoftë, kreditë joperformuese mbesin mirë të mbuluara me provizione (110.6 përqind), gjë që e relativizon ekspozimin e sektorit ndaj rrezikut kreditor.

Rritja ekonomike për vitin 2014 pritet të përshpejtohet në krahasim me vitin paraprak. Faktor kryesor në përshpejtim të rritjes ekonomike për vitin 2014 pritet të jetë komponenta e konsumit privat, ndërsa me efekt pozitiv pritet të jetë edhe konsumi publik. Sa i përket investimeve, efekti i tyre pritet të jetë neutral. Përkundër performancës pozitive të investimeve private, rënia e investimeve publike pritet të eliminojë efektin e investimeve në rritje. Me ndikim negativ në rritje pritet të jetë deficitit tregtar në mallra dhe shërbime i cili gjatë vitit 2014 pritet të përkeqësohet. Parashikimet e BQK-së sugjerojnë se norma reale e rritjes së PBB-së për vitin 2014 do të jetë 3.7 përqind.

Ecuria e çmimeve gjatë vitit 2014 pritet të karakterizohet me stabilitet si rezultat i rritjes modeste të çmimeve. Parashikimet janë se norma e inflacionit për vitin 2014 do të jetë në rreth 1 përqind. Ky nivel i inflacionit pritet të jetë si rezultat i trendit rënës në nivel global të çmimeve në produktet kryesore, sidomos atyre që Kosova importon më shumë si nafta dhe produktet ushqimore. Gjithashtu edhe zhvillimet e brendshme, si ulja e çmimit të disa kategorive të çmimeve të administruara (p.sh. edukimi) pritet të kontribuojë që inflacioni të jetë i moderuar. Në anën tjetër, çmimet në sektorët e pa-tregtueshme mund të rriten si rezultat i rritjes së pagave në sektorin publik, ndërsa inflacioni mund të ndikohet edhe nga rritja e çmimeve të energjisë elektrike.


2. Ekonomia globale dhe eurozona

Ekonomia botërore ka vazhduar të rikuperohet gradualisht gjatë vitit 2013, megjithëse me diferenca të dukshme në mes të rajoneve. Për dallim nga vitet paraprake, impulsi kryesor i rritjes ekonomike globale në vitin 2013 duket të jetë zhvendosur nga ekonomitë në zhvillim tek ekonomitë e zhvilluara. (figura 1). Rritja e aktivitetit ekonomik në nivel global është mbështetur kryesisht nga ekonomia e SHBA-së, Japonisë, Mbretërisë së Bashkuar dhe disa nga vendet më të zhvilluara të eurozonës si Gjermania dhe Franca. Në vitin 2013, rritja ekonomike në nivel global shënoi normën prej 3.0 përqind. Në gjysmën e parë të vitit 2013, rritja ekonomike globale ishte 2.7 përqind, duke u përshpejtuar në gjysmën e dytë të vitit në 3.7 përqind. Përderisa krahasuar me vitin paraprak, disa nga ekonomitë e zhvilluara u karakterizuan me rritje më të shpejtë vjetore, vendet në zhvillim në periudhën e njëjtë treguan shenja të ngadalësimit. Megjithatë, ekonomitë në zhvillim vazhdojnë të mbajnë peshën kryesore të rritjes globale. Ekonomitë në zhvillim shënuan rritje prej 4.7 përqind në vitin 2013, përderisa norma e rritjes në ekonomitë e zhvilluara ishte 1.3 përqind në këtë periudhë. Gjatë vitit 2013, pjesa më e madhe e ekonomive botërore kishin koncentruar politikat e tyre ekonomike drejtë nxitjes dhe mbështetjes së aktivitetit ekonomik kryesisht përmes vazhdimit të politikave akomoduese monetare dhe lehtësimit të politikave të shtrënguara fiskale.

Ekonomia e eurozonës ka vazhduar rrugëtimin e rimëkëmbjes nga recesioni i gjysmës së parë të vitit drejtë rimëkëmbjes në gjysmën e dytë të vitit 2013. Gjatë këtij viti, eurozona u karakterizua me një rënie vjetore të GDP-së prej 0.5 përqind. Megjithatë, edhe në kuadër të vendeve në eurozonë është vënë re një dallim në ritmin me të cilin po rikuperohen ekonomitë kryesore të këtij unioni si Gjermania dhe Franca krahasuar me ekonomitë më periferike të eurozonës.


Gjermania shënoi një rritje vjetore prej 0.5 përqind në vitin 2013, përderisa vetëm në tremujorin e fundit të vitit 2013 kishte një rritje vjetore prej 1.4 përqind. Rikuperimi i aktivitetit ekonomik në Gjermani është mbështetur kryesisht nga rritja e konsumit privat dhe publik si rezultat i normave të ulëta të interesit që mbizotëruan përgjithësisht tregun evropian. Gjithashtu, përmirësimi i kushteve në tregjet e punës dhe përmirësimi i besueshmërisë kanë ndikuar në nxitjen e kërkesës së brendshme, duke u reflektuar në konsum dhe investime më të larta. Perceptimi për përmirësimin e besueshmërisë në Gjermani në vitin 2013 është vlerësuar përmes indeksit të biznesit IFO, që shërben si një ndër indikatorët kryesor për vlerësimin e aktivitetit ekonomik në Gjermani. Nga figura 2 vëmë re se përmirësimi i klimës së biznesit në Gjermani në vitin 2013 krahasuar me vitin 2012, si dhe pritjet optimiste për vitin 2014 në linjë me zhvillimet

Figura 1. Rritja reale e PBB-së



Burimil: IMF WEO (Prill 2014)

Figura 2. Klima e biznesit në Gjermani dhe rritja ekonomike



Burimil: IFO (2014)

në tremujorin e parë të vitit 2014 është përkthyer në rritjen e aktivitetit ekonomik gjatë kësaj periudhe (figura 2). Jashtë zonës së vendeve kryesore ekonomike në eurozonë, rritja ekonomike u nxit kryesisht nga rritja e eksporteve si dhe stabilizimi gradual i kërkesës së brendshme. Megjithatë, rritja e kërkesës në eurozonë mund të frenohet deri në një masë në vitin 2014 nga prezenca e fragmentimit financiar, nivelit të ulët të kreditimit si dhe nivelit të lartë të borxhit të korporatave. Deri në vitin 2008, unioni monetar ka ndikuar në thellimin e integritimit financiar në vendet evropiane, përderisa kriza e fundit financiare është karakterizuar me fragmentim të tregjeve financiare evropiane. Fragmentimi financiar në vendet evropiane kryesisht është paraqitur në formë të rënies së investimeve ndërkufitare në fletëobligacione qeveritare dhe tkurrjes së kreditimit ndërkufitar. Edhe shqetësimet rreth borxhit publik mbeten evidente pasi që borxhi publik në vitin 2013 arriti në 95.7 përqind të PBB-së krahasuar me 92.9 përqind në vitin 2012, përkundër rënies së deficitit buxhetor. Mirëpo, parashikimet për rritje ekonomike në vitin 2014 pritet të përmirësojnë qëndrueshmërinë dhe tejkalimin e krizës së borxheve publike, gjë që do të reflektohej në rritjen e shkallës së besueshmërisë në tregje dhe uljen e kostos së financimit.

Aktiviteti ekonomik është rritur me ritëm më të moderuar në vendet në zhvillim në vitin 2013 krahasuar me vitin paraprak. Me rritje më të ngadalshme vjetore në vitin 2013 janë karakterizuar India dhe Rusia prej 4.4 përqind përkatësisht 1.3 përqind (4.7 përqindësisht 3.4 përqind në vitin 2012) përderisa ekonomia e Kinës shënoi rritje pothuajse të njëjtë me vitin paraprak prej 7.7 përqind. Vendet në zhvillim u karakterizuan me rritje të eksporteve, që rezultoi nga rritja e aktivitetit ekonomik në vendet e zhvilluara. Në anën tjetër, investimet mbetën në nivel të ulët, përderisa financimi i jashtëm dhe kushtet e brendshme financiare u shtrënguan në vazhdimësi. Tregjet financiare kanë qenë kryesisht stabile gjatë vitit 2013, me përjashtim të tremujorit të tretë të vitit kur u tensionuan sidomos në vendet në zhvillim. Tregjet financiare u tensionuan kryesisht si pasojë e deklaratës së FED-it në maj 2013 për mundësinë e përfundimit të programit mbështetës në SHBA, gjegjësisht të blerjes së letrave me vlerë të qeverisë dhe derivateve hipotekare (pako e një numri të kredive hipotekare të siguruara) brenda një të ardhme të afërt. Ky program ka ndikuar në zvogëlimin e normave të interesit në SHBA, veçanërisht koston e kredive hipotekare dhe koston e financimit për bizneset. Përderisa konsumatorët kanë përfituar nga kosto më e ulët e blerjes së shtëpive dhe kosto më e ulët për financim të bizneseve, investitorët kanë qenë më të prirur për të investuar në tregjet e aksioneve për të realizuar kthim më të lartë se investimet në letrat me vlerë të qeverisë. Rritja e tensioneve goditi veçanërisht tregjet në zhvillim, me ç'rast rritja e pasigurisë ndikoi në rritjen e normave të interesit si pasojë e rritjes potenciale të normave të interesit në SHBA, dhe në zhvlerësimin e monedhave në disa nga vendet në zhvillim.


Sa i përket pritjeve për aktivitetin ekonomik, rritja ekonomike për eurozonën për dy vitet e ardhshme pritet të arrijë në 1.2 përqind përkatësisht 1.5 përqind në vitin 2014 dhe 2015. Gjithashtu, rritja e parashikuar ekonomike në vendet në zhvillim pritet të rritet nga 4.7 përqind në vitin 2013 në 4.9 përqind në vitin 2014 dhe 5.3 përqind në vitin 2015.

Në vitin 2013, rënia e çmimeve të lëndëve të para në tregjet ndërkombëtare, sidomos çmimet e lëndëve djegëse dhe ushqimit, si dhe rritja ende e ngadalshme e ekonomisë globale ndikuan në zbutjen e presioneve inflacioniste. Bankat qendrore në rajonet e rëndësishme vazhduan të vazhduan të ndjekin politika lehtësuese monetare gjatë vitit 2013, kryesisht për shkak të nxitjes së aktivitetit ekonomik dhe rrezikut potencial nga deflacioni i mundshëm në SHBA, eurozonë dhe Japoni. Inflacioni në nivel global në vitin 2013 qëndroi në 3.6 përqind, nga 3.9 përqind sa ishte në vitin 2012. Në vendet e zhvilluara, më konkretisht në SHBA, Japoni dhe eurozonë inflacioni ishte nën cakun e përcaktuar nga bankat qendrore prej 2 përqind. Në vitin 2013, norma e inflacionit në SHBA, Japoni dhe eurozonë qëndroi në 1.5, 0.4 përkatësisht 1.3 përqind. Vendet në zhvillim u karakterizuan me normë lehtësisht më të ulët të inflacionit në vitin 2013

prej mesatarisht 5.8 përqind, krahasuar me vitin paraprak kur kishin një normë të inflacionit prej 6.0 përqind (figura 2).

Presionet e ulëta inflacioniste në vendet e zhvilluara ishin edhe pasojë e rënies së kostove në tregjet e punës, që pasqyrohen edhe në hendekun e prodhimit që rezultoi në këto vende. Normat e papunësisë për një pjesë të madhe të vendeve të zhvilluara dhe vendeve në zhvillim shënuan rritje në vitin 2013 krahasuar me vitin paraprak. Përjashtim bëjnë ekonomia e SHBA-ve, që në vitin 2013 u karakterizua me rënie të normës së papunësisë, pavarësisht presioneve të ulëta inflacioniste. Norma vjetore e papunësisë në SHBA në vitin 2013 qëndroi në 7.4 përqind, për dallim nga viti paraprak kur ishte 8.1 përqind. Në eurozonë, norma e papunësisë në vitin 2013 u ngrit në 12.1 përqind, nga 11.4 përqind sa ishte në vitin 2012. Në kuadër të vendeve të eurozonës, Gjermania rezultoi të ketë përmirësuar gjendjen në tregun e punës, duke zvogëluar normën vjetore të papunësisë në 5.3 përqind në vitin 2013 (5.5 përqind në vitin 2012). Të gjitha vendet tjera të zhvilluara (me përjashtim të Danimarkës dhe Estonisë), dhe veçanërisht vendet periferike të eurozonës u karakterizuan me rritje të normës së papunësisë në vitin 2013 (figura 3).


Figura 3. Papunësia, në përqindje



Burimi: IMF, WEO (Prill 2014)

Kushtet në tregjet monetare dhe financiare në vendet e zhvilluara kanë mbetur kryesisht mbështetëse për rritjen ekonomike. Deklarata fillestare e FED për mbylljen graduale të fazës së lehtësimit sasior ndikoi në rritjen e tensioneve në tregjet financiare ndërkombëtare, duke rezultuar në rritje të përkohshme të normave afatgjata të interesit në tregjet e letrave me vlerë të qeverisë amerikane në fund të vitit 2013. Megjithatë, FED mbeti i përkushtuar në politikat e tij kundrejt mbajtjes së normave të interesit në nivel të ulët, politikë kjo që pritet të mbetet aktuale deri më 2015. Norma të ulëta të interesit përmes vazhdimit të politikave lehtësuese monetare priten të mbesin prezente edhe në eurozonë.

Figura 4. Inflacioni vjetor




Burimi: IMF, WEO (Prill 2014)

Në vitin 2013, kushtet e tregtimit në tregjet e borxhit janë përmirësuar kryesisht si rezultat i përmirësimeve të perceptimit të tregjeve mbi nivelin e rrezikut të vendeve me probleme të borxhit në eurozonë. Ndikim pozitiv në tregjet e borxhit në eurozonë kishte edhe deklarimi për vazhdimin e politikave mbështetëse të Bankës Qendrore Evropiane (BQE), pas uljes së mëtejme të normës bazë të interesit në muajin nëntor. Rreziqet që mbeten sfidë për eurozonën rikthehen tek rreziku nga fragmentimi financiar, që pritet të vijojë të pengojë përçimin e impulseve të politikës monetare në të gjitha vendet anëtare. Si pasojë, kushtet e kreditimit në eurozonë priten të mbeten deri në një masë të shtrënguara, përderisa përmirësimi gradual i bilanceve të dobëta të gjendjes tek bankat priten të rezultojnë në rritjen e kreditimit.

Në gjashtëmuorin e parë të vitit 2013, aktiviteti më i ngadalshëm ekonomik ndikoi edhe në zvogëlimin e vëllimit të tregtisë në nivel global. Megjithatë, rritja ekonomike në gjysmën e dytë të vitit 2013 u përforcua në vendet në zhvillim, duke u reflektuar kështu edhe në rritjen e vëllimit të tregtisë në këtë periudhë. Volumi i tregtisë globale shënoi rritje vjetore prej 3.0 përqind në vitin 2013 (2.8 përqind në vitin 2012). Tregtia globale u rrit me trend më të ngadalshëm krahasuar me pritjet, kryesisht si pasojë e aktivitetit më të ngadalshëm ekonomik në vendet në zhvillim. Deklarimi i FED për të përfunduar eventualisht programin sasior ka ndikuar vendet në zhvillim në zvogëlimin e flukseve kapitale, duke vështirësuar më tej financimin e deficitit të llogarisë rrjedhëse me të cilin karakterizohen pjesa më e madhe e vendeve në zhvillim. Raporti i deficitit të llogarisë rrjedhëse ndaj GDP-së në pjesën më të madhe të vendeve të zhvilluara mbeti pothuajse i pandryshuar. Në vitin 2013, SHBA-të zvogëluan deficitin e llogarisë rrjedhëse në 2.3 përqind të GDP-së (2.7 përqind të GDP-së në vitin 2012), kryesisht si rrjedhojë e rritjes së eksporteve gjatë kësaj periudhe (figura 5). në anën tjetër, eurozona dhe vendet në zhvillim u karakterizuan me bilanc pozitiv të llogarisë rrjedhëse prej 2.9 përkatësisht 0.7 përqind e pbb-së në vitin 2013 (2.0 përkatësisht 1.4 përqind në vitin 2012). vendet e eurozonës u karakterizuan me përmirësim të llogarisë rrjedhëse, si rrjedhojë e suficitit të shënuar në bilancin tregtar. në vitin 2013, vlera e eksporteve të eurozonës u karakterizua me rritje më të shpejtë krahasuar me vlerën e importeve, duke ndikuar në përmirësimin e pozicionit të neto eksporteve. Gjermania ishte vendi që shënoi rritje më të madhe të eksporteve në eurozonë.

Figura 5. Llogaria rrjedhëse si pjesëmarrje e PBB-së, në përqindje




Burimi: IMF, WEO (Prill 2014)

3. Evropa Juglindore

Viti 2013 ishte vit i rikuperimit të aktivitetit ekonomik në të gjitha vendet e Evropës Juglindore (EJL) pasi që norma mesatare e rritjes së PBB-së arriti në 2.3 përqind, përderisa në vitin paraprak EJL-ja ishte përballur me recesion ekonomik. Gjatë vitit 2013, Mali i Zi dhe Kosova shënuan normën më të lartë të rritjes ekonomike (3.4 përqind secila), pasuar nga Maqedonia (3.1 përqind), Serbia (2.5 përqind) dhe Bosnja e Hercegovina (1.2 përqind), ndërsa Shqipëria shënoi nivelin më të ulët të rritjes (0.7 përqind) (figura 6). Sa i përket parashikimeve për vitin 2014, të dhënat aktuale nga FMN-ja dhe Komisioni Evropian sugjerojnë se aktiviteti ekonomik në EJL pritet që në përgjithësi të jetë i ngjashëm me vitin 2013. Mirëpo, për shkak të dëmeve të shkaktuara nga kushtet klimatike në Bosnje e Hercegovinë dhe Serbi gjatë muajit maj 2014, këto parashikime mund të ulen.


Figura 6. Norma e rritjes së PBB-së reale në EJL



Burimi: FMN (2014) dhe parashikimet e BQK-së për Kosovën për vitin 2014

Gjatë vitit 2013, në pothuajse të gjitha vendet e EJL-së inflacioni shënoi rënie. Sipas të dhënave të Komisionit Evropian, mesatarja e inflacionit për vendet e EJL-së gjatë vitit 2013 ishte 2.9 përqind krahasuar me mesataren prej 3.5 përqind që ishte shënuar në vitin paraprak. Serbia, Mali i Zi dhe Maqedonia raportuan normat më të larta të inflacionit (7.3, 3.2, përkatësisht 2.8 përqind), Shqipëria dhe Kosova raportuan nivel të inflacionit prej 1.9 përkatësisht 1.8 përqind, ndërkaq Bosnja dhe Hercegovina raportoi deflacion prej 0.1 përqind (figura 7). Trendi i rënies së inflacionit është duke vazhduar edhe në vitin 2014 dhe sipas parashikimeve të Komisionit Evropian, pritet që mesatarja e inflacionit për EJL-në të jetë 2.5 përqind.

Figura 7. Norma mesatare vjetore e inflacionit në EJL




Burimi: Komisioni Evropian (2014)

Rritja e aktivitetit ekonomik në vendet e rajonit ka ndikuar në përmirësimin e lehtë të gjendjes në tregun e punës. Vlerësimet e fundit për vitin 2013 tregojnë për një shkallë mesatare të papunësisë në EJL prej 26.3 përqind, që është për 0.2 pikë përqindje më e ulët krahasuar me vitin e kaluar. Shkalla më e lartë e papunësisë vazhdon të jetë në Bosnje e Hercegovinë (44.5 përqind), Kosovë (30.9 përqind), Maqedoni (29.0 përqind), dhe Serbi (22.1 përqind), ndërsa shkallën më të ulët të papunësisë vazhdojnë ta kenë Mali i Zi (15.0 përqind) dhe Shqipëria (16.0 përqind).

Norma mesatare e deficitit të llogarisë rrjedhëse për vendet e EJL-së gjatë vitit 2013 ishte 7.4 përqind e PBB-së, që është për 2.6 pikë përqindje më e ulët krahasuar me vitin paraprak. Mali i Zi raportoi normën më të lartë të deficitit të llogarisë rrjedhëse, ndërsa Maqedonia normën më të ulët të deficitit. Përveç Shqipërisë e cila shënoi rritje të shkallës së deficitit të llogarisë rrjedhëse krahasuar me vitin 2012, në vendet tjera deficit i llogarisë rrjedhëse u zvogëlua (figura 8). Ky përmirësim i deficitit të llogarisë rrjedhëse ishte kryesisht

Figura 8. Deficiti i llogarisë rrjedhëse në EJL, në përqindje të PBB-së



Burimi: Komisioni Evropian (2014)

rezultat i rritjes së eksporteve prej mesatarisht 12.2 përqind, përderisa importet shënuan një ngritje të lehtë prej vetëm 0.2 përqind. Deficiti i llogarisë rrjedhëse në vendet e rajonit është përmirësuar edhe si pasojë e rritjes së transfereve rrjedhëse në shumicën e këtyre vendeve, ndërkohë që edhe bilanci i Investimeve të Huaja Direkte (IHD), i cili paraqet një komponentë shumë të rëndësishme për financimin e deficitit të llogarisë rrjedhëse, është përmirësuar.

Si rezultat i masave të kursimit të ndërmarra nga qeveritë e vendeve të rajonit, është shënuar përmirësim në bilancet e tyre buxhetore. Deficiti buxhetor është zvogëluar nga mesatarisht 4.3 përqind e PBB-së sa ishte në vitin 2012, në mesatarisht 3.8 përqind në vitin 2013. Shkallën më të lartë të deficitit buxhetor e shënoi Shqipëria (6.2 përqind të PBB-së), pasuar nga Serbia dhe Maqedonia (5.7 përkatësisht 4.0 përqind të PBB-së), ndërsa vendet tjera pritet të kenë nivele më të ulëta të deficitit buxhetor. Përkundër zvogëlimit të deficitit buxhetor, në vitin 2013 borxhi publik në EJL shënoi ngritje nga mesatarisht 44.3 përqind e PBB-së në vitin 2012 në mesatarisht 46.8 përqind të PBB-së në vitin 2013. Shqipëria dhe Serbia, përveç se kanë nivelin më të lartë të borxhit publik (70.5 përkatësisht 65.8 përqind e PBB-së), janë vendet të cilat në vitin 2013 e thelluan më së shumti borxhin publik krahasuar me vitin 2012. Kosova vazhdon të ketë shkallën më të ulët të borxhit publik në rajon me vetëm rreth 9.1 përqind të PBB-së. Edhe për vitin 2014, FMN-ja ka parashikuar rritje të borxhit publik në EJL, i cili pritet të arrijë në mesatarisht 48.0 përqind të PBB-së.

Tabela 1. Norma e rritjes së kredive dhe depozitave në vendet e EJL-së


Përshkrimi	Shqipëria		BIH		Maqedonia		Mali i Zi		Serbia		Kosova	
	2012	2013	2012	2013	2012	2013	2012	2013	2012	2013	2012	2013
Kreditë	7.4	-0.2	5.2	2.5	7.3	4.3	-0.7	3.1	12.9	-6.5	3.8	2.4
Depozitat	9.4	3.7	2.6	5.1	7.2	4.8	9.0	5.9	10.4	3.3	8.3	7.5

Burimi: Komisioni Evropian (2014)

Rritja e aktivitetit kreditues dhe depozitues në sektorët bankar të vendeve të EJL-së ka rënë dukshëm. Kreditë e sektorit bankar në EJL shënuan rritje prej mesatarisht 0.9 përqind në vitin 2013, krahasuar me rritjen prej 6.0 përqind të shënuar në vitin paraprak. Depozitat shënuan rritje mesatarisht prej 5.0 përqind, përderisa në vitin paraprak norma vjetore e rritjes ishte 7.8 përqind. Sipas të dhënave të publikuara nga Komisioni Evropian, ritmi i rritjes së kredisë u ngadalësua në Bosnjë e Hercegovinë, Maqedoni dhe në Kosovë, ndërsa në Serbi dhe Shqipëri kreditë shënuan rënie prej 6.5 përkatësisht 0.2 përqind. Me ngadalësim të trendit të rritjes u karakterizuan edhe depozitat, me përjashtim të Bosnje e Hercegovinës ku depozitat shënuan normë më të lartë të rritjes krahasuar me vitin paraprak (tabela1).

Përveç normave më të ulëta të rritjes së kredive dhe depozitave, sistemet bankare në EJT u karakterizuan edhe me përqendrim të cilësisë së portofolit kreditor gjatë vitit 2013. Shqipëria raportoi normën më të lartë të kredive jo-performuese prej 24.0 përqind, pasuar nga Serbia me 19.9 përqind, pastaj Mali i Zi me 18.4 përqind. Edhe në Bosnje e Hercegovinë u shënua përqendrim i normës së kredive jo-performuese nga 12.7 përqind në vitin 2012 në 14.5 përqind. Shkallën më të ulët të kredive jo-performuese vazhdon ta ketë Kosova, me vetëm 8.7 përqind të gjithsej kredive në vitin 2013 (7.5 përqind në vitin 2012) (figura 9).

Figura 9. Norma e kredive jo-performuese në EJT




Burimi: Komisioni Evropian (2014)

3.1. Çmimet e mallrave kryesore në tregjet ndërkombëtare

Çmimet e naftës (brent crude)¹ gjatë vitit 2013 shënuan rënie për 4.3 përqind krahasuar me vitin 2012. Zhvillimet në çmimet e naftës gjatë vitit 2013 ishin të nxitura nga rritja e prodhimit të naftës në SHBA që njëherit është edhe konsumuesi më i madh i naftës në nivel global. Prodhimi i brendshëm dhe rënia e importit të këtij produkti nga SHBA-të ndikoi që kërkesa për importim të naftës të zvogëlohet, duke shkaktuar edhe rënie të çmimit. Përveç rritjes së prodhimit në SHBA, edhe rritja e rezervave për absorbim të goditjeve nga ana e ofertës në vendet e zhvilluara ka ndikuar në nivelin aktual të çmimeve të naftës.


Figura 10. Çmimi i naftës 'brent crude', në USD



Burimi: Bloomberg, Deutsche Bank (2014), dhe kalkulime të BQK-së

Parashikimet për çmimet e naftës për vitin 2014 vazhdojnë të sugjerojnë tendencë rënëse për rreth 5-8 përqind (Bloomberg, Deutsche Bank, 2014), ndërsa në tremujorin e parë të 2014, rënia vjetore ishte 4.4 përqind (FMN, 2014). Faktorët kryesor që pritet të ndikojnë në rënie e çmimeve të naftës në vitin 2014 janë prodhimi i lartë në SHBA, rritja e rezervave në vendet e zhvilluara si dhe stabilizimi politik në disa vende të Lindjes së Mesme. Stabilizimi politik në disa vende prodhuese të naftës në Lindjen e Mesme ka ulur rrezikun nga ana e ofertës për naftën, gjë që pritet të ndikojë në çmimin e këtij produkti.

Figura 11. Çmimi i arit për ounce



Burimi: Bloomberg (2014) dhe kalkulime të BQK-së

¹'Brent Crude' paraqet klasifikim tregtar për naftën e prodhuar në detin e verit si përfaqësues i nivelit të çmimit të naftës në nivel global.

Përveç kësaj, ekziston mundësia e vështirësive në arritjen e marrëveshjes për zvogëlim të ofertës nga organizata e shteteve eksportuese të naftës, OPEC (angl. Organization of Petroleum Exporting Countries) që zakonisht bëhet me qëllim të rritjes së çmimeve të naftës (Bloomberg, 2014). Këto vështirësi në ulje të ofertës pritet të vijnë si rezultat i nevojave më të mëdha për eksportim të naftës nga vendet eksportuese, por gjithashtu edhe mundësia e lirimit nga sanksionet ndërkombëtare të Iranit mund të rrisë ofertën nga vendet e OPEC.

Rënia e çmimeve të naftës mund të ndikojë deri në një masë edhe në çmimet e mallrave të konsumit, sidomos atyre ushqimore, pasi që nafta dhe energjia përbëjnë komponentë mjaft të rëndësishëm në procesin e prodhimit dhe transportimit të tyre. Zvogëlimi i çmimeve të naftës gjatë vitit 2014 pritet të ndikojnë pozitivisht te vendet importuese të naftës si rezultat i përmirësimit të llogarive rrjedhëse. Ndryshimet në çmime të naftës kanë reflektuar edhe në deficitin e llogarisë rrjedhëse në Kosovë pasi që të dhënat tregojnë se sasia e importuar e naftës është rritur, ndërsa vlera nominale e pagesave për këtë produkt ka shënuar rënie të konsiderueshme.


3.1.1 Çmimet e arit

Përveç rënies së çmimeve të shumë prej mallrave kryesore të tregtuara në tregjet ndërkombëtare, pas një periudhe të vazhdueshme të rritjes, edhe çmimet e arit kanë shënuar rënie gjatë vitit 2013 (figura 11). Çmimi i arit gjatë vitit 2013 ka shënuar rënie për 15.4 përqind (rritje për 6.4 përqind në vitin 2012). Ari në shumë raste në tregjet globale përdoret si masë mbrojtëse nga inflacioni dhe nga pasiguritë që shkaktojnë tregjet e aksioneve dhe rezervat në valutë. Me gjithë rritjen e kërkesës, pritet për norma të ulëta të inflacionit dhe mundësisë së deflacionit, çmimi i arit ka shënuar rënie të vazhdueshme. Përveç kësaj, edhe problemet e borxhit në disa vende të eurozonës që ishin prezente gjatë vitit 2012 kanë ndikuar që të krijohen pritjet se disa vende mund të shesin rezervat e arit, si mënyrë e vetme për pagesë të borxhit. Kjo ka rezultuar në rënie të çmimit të arit si rezultat i pritjeve për rritjen e ofertës së këtij produkti. Gjithashtu, gjatë vitit 2013 dhe 2014 ari shihet më pak si masë mbrojtëse dhe investuese pasi që asete tjera si tregjet e kapitalit kanë kthime relativisht të larta. Pritjet aktualisht janë se rënia e çmimeve të arit mund të vazhdojë edhe gjatë vitit 2014 por në normë më të ngadalësuar (Bloomberg, 2014). Të dhënat për tremujorin e parë të vitit konfirmojnë pritjet për ngadalësim të rënies së çmimit të arit pasi që mesatarja e çmimit për tremujorin e parë është e ngjashme me mesataren e tremujorit të katërt të vitit 2013.

3.1.2 Çmimet e metaleve tjera

Rënia e çmimeve të produkteve kryesore është reflektuar edhe në çmimet e metaleve që gjatë viteve u karakterizuan me ndryshime të vogla dhe tendencë rënëse. Gjatë vitit 2013, metalet tjera kanë shënuar rënie të lehtë krahasuar me vitin 2012. Përjashtim këtu bënë çmimi i aluminit, i cili ka regjistruar rënie prej 13 përqind si rezultat i ofertës së lartë për këtë produkt në nivel global. Edhe çmimi i zinkut ka pasur rënie prej 3.5 përqind për shkak të ofertës së lartë, por rënia ishte më e moderuar si rezultat i rritjes së kërkesës në disa vende në zhvillim. Ndërsa, çmimi i plumbit ka mbetur në nivel të ngjashëm si rezultat i rikuperimit të

Figura 12. Çmimet e metaleve, në USD për ton



Burimi: Bloomberg (2014) dhe kalkulime të BQK-së


industrisë automobilistike në nivel global (figura 12), (ABN-AMRO, 2013). Në tremujorin e parë të vitit 2014, çmimet e metaleve u karakterizuan me trend të ngjashëm me vitin paraprak. Rënie prej 4.0 dhe 1.3 përqind shënuan alumini përkatësisht plumbi, ndërsa çmimet e zinkut u rritën me 4.8 përqind.

Parashikimet e FMN-së sugjerojnë se çmimet e metaleve kryesore pritet të jenë relativisht stabile gjatë vitit 2014 si rezultat i rritjes së kërkesës dhe investimeve në nivel global (FMN, Prill 2014). Lëvizjet në çmimet e metaleve reflektohen relativisht shumë në ekonominë e Kosovës pasi që eksportet e Kosovës kanë shkallë relativisht të lartë të koncentrimin në metale.

3.1.3 Çmimet e prodhimeve ushqimore


Rënia vjetore e çmimeve të naftës është reflektuar edhe në çmimet e ushqimit që gjithashtu në nivel global kanë shënuar rënie, pasi që komponenta e energjisë është mjaft e rëndësishme në procesin e prodhimit të mallrave konsumuese. Indeksi i çmimeve të ushqimit gjatë vitit 2013 shënoi rënie për 1.6 përqind, rënie kjo që kryesisht është nxitur nga çmimet e drithërave, të cilat shënuan rënie për 7.2 përqind. Ndër faktorët kryesor që ka ndikuar në rënien e çmimeve të ushqimit në nivel global ishte oferta relativisht stabile gjatë vitit 2013. Sidoqoftë, viti 2014 mund të jetë vit me luhatje substanciale të çmimeve të ushqimit si rezultat i thatësirave që kanë karakterizuar disa nga vendet e zhvilluara, sidomos SHBA-të por edhe vërshimeve të cilat ndodhën në disa nga vendet e rajonit në pjesën e parë të vitit 2014.

Figura 13. Gjithsej eksportet (jo kumulative) dhe



Burimi: FMN (2014) dhe ASK (2014)

Figura 14. Indeksi i çmimeve të ushqimit



Burimi: FAOUN (2014)


4. Përmbledhje e zhvillimeve të përgjithshme makroekonomike në Kosovë

Zhvillimet ekonomike në Kosovë gjatë vitit 2013 kanë qenë kryesisht pozitive për të gjithë sektorët e ekonomisë. Indeksi i kombinuar² që përbëhet nga tregues të ndryshëm makroekonomik pasqyron zhvillimet sektoriale dhe vlerësimin mbi ndikimin e tyre në aktivitetin ekonomik (figura 15) dhe mbi rrezikun ekonomik (figura 16). Vlerësimet gjatë pjesës më të madhe të vitit 2013 tregojnë për ndikim pozitiv në aktivitetin ekonomik nga po thuajse të gjithë sektorët. Kjo ka qenë e theksuar sidomos në

tremujorin e dytë dhe tretë të vitit 2013, ndërsa për një periudhë të shkurtër (shtator dhe tetor), ngadalësimi i rritjes së kredive ka zvogëluar aktivitetin e përgjithshëm. Sidoqoftë, këto zhvillime janë rikuperuar në dy muajt e fundit të vitit 2013. Sektor tjetër me ndikim mjaft të lartë në aktivitetin ekonomik është konsideruar sektori i jashtëm, i cili përveç përmirësimeve në bilancin tregtar, është karakterizuar me rritje të theksuar të IHD-ve, sidomos deri në tremujorin e tretë të vitit 2013. Sektori fiskal gjatë vitit 2013 në përgjithësi ka kontribuar pozitivisht duke mbajtur nivel relativisht stabil të indeksit. Implikimet e zhvillimeve globale gjatë tremujorit të fundit kanë qenë pozitive për ekonominë e Kosovës. Këto zhvillime gjatë vitit 2013 në përgjithësi kanë ndikuar që rreziku ekonomik në vend të zvogëlohet gjatë pjesës më të madhe të vitit.


Zhvillimet në indeksin e kombinuar të aktivitetit ekonomik gjatë muajve të parë të vitit 2014 tregojnë për stabilitet makroekonomik dhe aktivitet deri diku pozitiv. Gjithashtu, si rezultat i aktivitetit pozitiv, edhe rreziku ekonomik gjatë vitit 2014 qenë negativ, që nënkupton rënie të rrezikut nga sektorët përkatës.

Figura 15. Indeksi i kombinuar mbi ndikimin sektorial në aktivitetin ekonomik



Burimi: BQK (2014)

Figura 16. Indeksi i kombinuar mbi ndikimin sektorial në rrezikun ekonomik



Burimi: BQK (2014)

²Indeksi i kombinuar derivohet nga indikatorët e ndryshëm makroekonomik. Secili sektor i ekonomisë përbëhet nga indikatorë të ndryshëm dhe fillimisht vlerësohet ndikimi i tyre në sektorë, pastaj vlerësohet ndikimi i të gjithë sektorëve në gjithsej aktivitetin dhe rrezikun ekonomik. Ky ndikim vlerësohet duke u bazuar në pesha të caktuara për secilin indikatorë dhe se vlerat numerike mund të jenë nga 1.0 që paraqet ndikim shumë pozitiv deri në -1.0 që paraqet ndikim shumë negativ.

4.1. Produkti i brendshëm bruto


Treguesit kryesor makroekonomik sugjerojnë se aktiviteti ekonomik në Kosovë gjatë vitit 2013 ka shënuar rritje. Sipas vlerësimeve të ASK-së, rritja reale e PBB-së në vitin 2013 ishte 3.4 përqind apo 0.7 pikë përqindje më e lartë se sa në vitin 2012 (figura 17). Kontributin kryesor në rritjen e PBB-së e kishin konsumi dhe neto eksportet përderisa investimet në vitin 2013 kanë pasur një kontribut të lehtë negativ. Vlera nominale e PBB-së për vitin 2013 sipas ASK-së vlerësohet të ketë arritur në 5.32 miliardë euro (figura 18).

Komponenta kryesore e PBB-së në Kosovë vazhdon të jetë konsumi, me pjesëmarrje prej 104.2 përqind në vitin 2013. Konsumi privat gjatë kësaj periudhe vlerësohet se ka shënuar rritje reale prej 2.0 përqind, ndërsa konsumi publik ka shënuar rritje prej 3.3 përqind. Konsumi privat vlerësohet të ketë qenë bartës i rritjes së gjithsej konsumit për shkak të peshës më të madhe që ka (84.4 përqind e gjithsej konsumit). Rritja e konsumit privat i atribuohet kryesisht rritjes së remitencave dhe kredive konsumuese, përderisa rritja e shpenzimeve rrjedhëse të qeverisë i kontribuoj rritjes së konsumit publik.

Investimet, të cilat kanë një pjesëmarrje prej 27.6 përqind në PBB, vlerësohet të kenë shënuar rënie reale për 0.3 përqind në vitin 2013. Sidoqoftë, për dallim nga viti paraprak kur investimet shënuan rënie reale prej mbi 10 përqind, pozicioni i tyre gjatë vitit 2013 konsiderohet të jetë stabilizuar. Stabilizimi i investimeve gjatë vitit 2013 vlerësohet të ketë qenë i nxitur nga investimeve private, të cilat përbëjnë rreth 64.3 përqind të gjithsej investimeve. Rritja e investimet private, ndër të tjera, vlerësohet të ketë qenë rezultat i rritjes së investimeve të huaja direkte (IHD) dhe kredive investuese.


Gjatë vitit 2013, pozicioni i neto eksporteve në vend u karakterizua me përmirësim në terma real dhe nominal. Pozicioni i neto eksporteve u përmirësua për 3.6 përqind. Gjatë vitit 2013, bilanci tregtar në mallra u përmirësua si rezultat i rritjes reale të eksporteve për 12.8 përqind dhe rënies reale të importeve për 2.9 përqind. Sa i përket shërbimeve, eksporti real i tyre shënoi rënie për 2.2 përqind, ndërsa importi i tyre shënoi rritje për 10.1 përqind. Këto zhvillime kanë ndikuar që deficitin në neto eksporte të jetë më i ulët në krahasim me vitin paraprak dhe rrjedhimisht, të kontribuojë pozitivisht në rritje.

Figura 17. Rritja reale e PBB-së



Burimi: ASK (2014)

Figura 18. Komponentat kryesore të PBB-së, vlera nominale, në miliardë euro




Burimi: ASK (2014)

4.2. Sektori i Ndërmarrjeve

Zhvillimet në kuadër të ndërmarrjeve private gjatë vitit 2013 u karakterizuan me përkeqësim të raportit të ndërmarrjeve të reja kundrejt ndërmarrjeve të mbyllura. Gjatë vitit 2013, numri i gjithsej ndërmarrjeve të reja që u hapën ishte 9421, apo 171 biznese më pak se në vitin e kaluar. Gjithsej numri i bizneseve të mbyllura arriti në 1508, apo 427 më shumë se në vitin paraprak. Sidoqoftë, duke marrë parasysh nivelin e lartë të regjistrimeve të reja në dy vitet e fundit, është e pritur që numri i bizneseve të mbyllura të rritet. Në krahasim me vendet tjera të rajonit, të dhënat mbi bizneset e regjistruara vazhdojnë të jenë inkurajuese në Kosovë pasi që mbyllja e bizneseve ende ka raportin në mes të 1 dhe 2 biznese që mbyllen nga 10 biznese sa hapen, ndërsa vendet tjera ballafaqohen me mbi 3 mbyllje të bizneseve në çdo 10 biznese që hapen brenda vitit të parë. Struktura e ndërmarrjeve të reja të regjistruara ka vazhduar të jetë e ngjashme me vitet paraprake, por se ky vit është karakterizuar me përshpejtim të rritjes së bizneseve të reja në bujqësi dhe patundshmeri, ndërsa tregtia ka mbajtur nivelin e ngjashëm me vitet paraprake (figura 20). Këto të dhëna përputhen me të dhënat e kreditimit sipas industrive, ku vërehet se është rritur përkrahja e sistemit bankar ndaj bujqësisë, patundshmerisë dhe hotelarisë, ndërsa kreditimi ndaj tregtisë ka mbajtur nivel të ngjashëm me vitin paraprak. Bujqësia si njëra nga industritë me trend pozitiv të zhvillimit gjatë këtij viti ka pasur përkrahje më të madhe edhe nga qeveria nëpërmjet subvencioneve dhe transfereve.


Gjatë vitit 2013, Oda Ekonomike e Kosovës ka filluar që në baza tremujore të realizojë anketën me biznese mbi klimën e biznesit. Sipas anketës së Odës Ekonomike të Kosovës (OEK) me bizneset aktiviteti i bizneseve gjatë vitit 2013 ka qenë kryesisht pozitiv, sidomos në pjesën e dytë të vitit, ndërsa pjesa e parë është karakterizuar me zhvillime neutrale (figura 21). Pritjet e bizneseve për aktivitetin ekonomik gjatë gjysmës së parë të vitit 2014 janë raportuar të jenë optimiste. Sektorët më optimist për gjashtëmujorin e parë të vitit 2014 janë sektori i tregtisë,

Figura 19. Regjistri i bizneseve, jo kumulative




Burimi: ASK (2014)

Figura 20. Struktura e ndërmarrjeve të reja



Burimi: ASK (2014)

Figura 21. Vlerësimi i bizneseve për situatë biznesore në tre muajt e kaluar, indeks



Burimi: OEK (2014)

ndërtimtarisë, tregtisë me shumicë, prodhimit si dhe sektori i shërbimeve, ndërsa me pritje negative mbetet sektori i tregtisë me pakicë.

4.3 Çmimet

Ekonomia e Kosovës në vitin 2013 kishte një nivel mjaft të ulët të inflacionit, që është në përputhje me zhvillimet globale të çmimeve. Norma mesatare vjetore e inflacionit, shprehur përmes indeksit të çmimeve të konsumit (IÇK), në vitin 2013 ishte 1.8 përqind, që është më e ulët se sa norma prej 2.5 përqind e shënuar në vitin 2012.

Kontributin³ kryesor në këtë nivel të inflacionit gjatë vitit 2013 e kishin ushqimi dhe pijet joalkoolike me 0.8 pikë përqindje si dhe pijet alkoolike dhe duhani me 0.5 pikë përqindje, ndërsa, për shkak të rënies së çmimit të derivateve të naftës, shpenzimet e transportit kontribuan negativisht me 0.3 pikë përqindje në nivelin e përgjithshëm të inflacionit (figura 22). Kjo rënie shkallës së inflacionit është reflektuar kryesisht përmes nivelit më të ulët të rritjes së çmimeve të mallrave të importuara që është rezultat i presioneve deflacioniste në vendet e eurozonës me të cilat Kosova realizon pjesën më të madhe të shkëmbimeve tregtare.

4.3.1 Struktura e inflacionit dhe inflacioni bazë

Sa i përket komponentëve të IÇK-së, rritje e çmimeve gjatë vitit 2013 u shënuar tek pijet alkoolike dhe duhani me 7.2 përqind, veshmbathja me 2.9 përqind, rekreacioni dhe kultura me 2.7 përqind, ushqimi dhe pijet joalkoolike me 2.1 përqind, etj., ndërsa rënie e çmimeve u shënuar tek transporti me 1.9 përqind dhe mjetet e komunikimit me 0.9 përqind.

Çmimet e ushqimit dhe pijeve joalkoolike gjatë vitit 2013 u ngritën për 2.1 përqind apo 1.2 pikë përqindje më shumë se sa në vitin paraprak. Në kuadër të kategorisë së ushqimit, rritja me e theksuar është shënuar tek pemët me 9.1 përqind dhe perimet me 7.9 përqind, ndërsa për shkak të rritjes së rendimenteve në bujqësi, çmimet e bukës dhe drithërave kanë shënuar rënie për 1.7

Figura 22. Inflacioni dhe kontribuesit kryesor të tij, rritja vjetore në përqindje




Figura 23. Çmimet e ushqimit dhe kategoritë kryesore të tij, rritja vjetore në përqindje





Figura 24. Çmimet e strehimit, ujit dhe energjisë, rritja vjetore në përqindje




³Kalkulimi i kontributit të komponentëve të IÇK-së në nivelin e inflacionit, përveç lëvizjes së çmimeve, bazohet edhe në peshën që kanë komponentët e caktuar në IÇK.

përqind. Edhe çmimet e qumështit djathit dhe vezëve kanë shënuar rënie për 0.2 përqind (figura 23).

Çmimet e strehimit, ujit dhe energjisë gjatë vitit 2013 shënuan rritje mesatare prej vetëm 0.4 përqind (8.4 përqind rritje në vitin 2012). Kjo rritje dukshëm më e ulët e çmimeve të kësaj kategorie krahasuar me vitin paraprak ishte për shkak të rënies së çmimit të rrymës, gazit dhe lëndëve tjera djegëse prej 0.2 përqind si dhe rënies së çmimeve të mirëmbajtjes dhe rregullimit të vendbanimeve prej 0.4 përqind. Në anën tjetër, rritje të çmimeve shënuan pagesat për banim prej 4.2 përqind si dhe rritja e çmimit të furnizimit me ujë dhe shërbimeve të ndryshme që kanë të bëjnë me vendbanimin që shënuan rritje prej 2.7 përqind (figura 24).

Rritja mesatare vjetore e çmimeve të shërbimeve prej 1.5 përqind në vitin 2013 ishte e ngjashme me rritjen e çmimeve të kësaj kategorie në vitin paraprak. Rritja e çmimeve të shërbimeve është ndikuar kryesisht nga rritja e çmimeve të shërbimeve për rekreacion me 2.7 përqind, shërbimeve të hotelerisë me 1.8 përqind, shërbimeve shëndetësore me 0.7 përqind. Në anën tjetër, çmimet e shërbimeve të transportit dhe të komunikimit kanë shënuar rënie për 1.9 përkatësisht 0.9 përqind, përderisa çmimet e shërbimeve arsimore kanë mbetur të pandryshuara (figura 25).


Figura 25. Çmimet e shërbimeve, rritja vjetore në përqindje



Burimi: ASK dhe kalkulimet e BQK-së (2014)

Shporta e konsumatorit kosovar karakterizohet me pjesëmarrje mjaft të lartë të produkteve të cilat kanë lëvizje sezonale të çmimeve. Këtu përfshihen ushqimi, energjia, pijet alkoolike dhe duhani të cilat përbëjnë rreth gjysmën e shportës së konsumatorit. Çmimet e këtyre produkteve kanë determinuar lëvizjen e çmimeve gjatë viteve të kaluara, jo vetëm për shkak të pjesëmarrjes së lartë që e kanë në shportën e konsumatorit por edhe për shkak se lëvizja e këtyre çmimeve ka qenë më e theksuar (tabela 2). Kjo bënë

Figura 26. Inflacioni i përgjithshëm dhe inflacioni bazë, rritja vjetore në përqindje



Burimi: ASK dhe kalkulimet e BQK-së (2014)

që ndikimi i këtyre kategorive në gjithsej lëvizjen e çmimeve të jetë më i lartë se sa në vendet tjera të cilat kanë pjesëmarrje më të ulët të këtyre kategorive në shportën e konsumatorit. Sidoqoftë, në vitet e fundit vërehet një stabilitet i çmimeve të këtyre produkteve por edhe tendencë rënëse në nivelin e pjesëmarrjes në gjithsej shportën e konsumatorit.

Tabela 2. Ndarja e IÇK-së

Përshkrimi	Pëshat 2013	Mesatarja vjetore e rritjes, %					
		2008	2009	2010	2011	2012	2013
IÇK	100.0%	9.1	-2.3	3.5	7.3	2.5	1.8
<i>Ndarja e IÇK-së:</i>							
Ushqimi	37.8%	16.0	-4.4	4.7	12.2	0.9	2.1
Energjia	7.1%	4.9	5.0	4.3	1.2	8.4	0.4
Mallrat tjerë	22.4%	0.3	2.4	0.7	3.9	4.6	4.4
Shërbimet	32.7%	1.9	-2.5	1.9	3.2	1.5	1.5
<i>Inflacioni bazë, përjashtuar:</i>							
Ushqimin	62.2%	3.3	-0.6	1.7	2.6	2.1	0.9
Ushqimin dhe energjinë	55.1%	2.9	-0.9	1.3	2.5	1.5	0.9
Ushqimin, energjinë, pijet alkoolike dhe duhanin	49.9%	3.0	-1.3	1.2	2.2	1.0	0.4

Burimi: ASK dhe kalkulimet e BQK-së (2014)

Inflacioni bazë, i cili përjashton kategoritë të cilat karakterizohen me lëvizje sezonale të çmimeve si rezultat i ofertës, paraqet një pasqyrë më të qartë lidhur me inflacionin në Kosovë. Lëvizja e inflacionit bazë ka qenë më stabile se sa lëvizja e inflacionit të përgjithshëm (figura 26). Më specifikisht, inflacioni bazë, i cili përjashton ushqimin, energjinë, pijet alkoolike dhe duhanin gjatë vitit 2013 ka rënë në 0.4 përqind nga 1.0 përqind sa ishte në vitin paraprak, ndërsa inflacioni bazë i cili përjashton vetëm ushqimin ishte dukshëm më i ulët krahasuar me vitin paraprak (tabela 2).


4.3.2 Çmimet e importit dhe prodhimit

Lëvizjet e çmimeve në Kosovë janë mjaft të ngjashme me lëvizjet e çmimeve në tregjet ndërkombëtare si pasojë e varësisë së lartë të ekonomisë së Kosovës në importe. Kjo konfirmohet deri diku edhe nga sjellja e ngjashme e indeksit të çmimeve të importit me IÇK-në (figura 27). Mesatarja e çmimeve të importit gjatë vitit 2013 ka shënuar një ngritje të lehtë prej 0.2 përqind (5.3 përqind rritje në vitin 2012). Në kuadër të çmimeve të importit, çmimet e këpucëve kanë shënuar rritjen më të lartë gjatë vitit 2013 prej 11.6 përqind,

pasuar nga druri dhe artikujt e tij me 8.5 përqind, pastaj vajrat ushqimore me 6.7 përqind, etj. Në anën tjetër, çmimet e metaleve bazë kanë shënuar rënien më të lartë prej 3.1 përqind, pasuar nga produktet minerale të cilat përbëhen kryesisht nga nafta dhe derivatet e saj të cilat shënuan rënie për 2.2 përqind, ndërkohë që në vitin paraprak patën shënuar rritje prej 17.3 përqind.

Çmimet e prodhimit u karakterizuan me rritje mesatare vjetore prej 2.5 përqind, që është dukshëm më e lartë se sa rritja e çmimeve të konsumit dhe çmimeve të importit. Norma e rritjes së çmimeve të prodhimit ishte më e lartë edhe sa i përket krahasimit me vitin paraprak i cili ishte karakterizuar me 1.7 përqind rritje të çmimeve të prodhimit. Kjo rritje çmimeve të prodhimit më së shumti u nxit nga rritja e çmimeve të cilat konsiderohen si çmime të administruara siç janë: nxjerrja e qymyrgurit, linjitit dhe mineraleve të cilat shënuan rritje prej 37.5 përqind, pasuar nga rritja e çmimeve të industrive tjera nxjerrëse prej 21.4 përqind. Rritje shënuan edhe çmimet e industrisë së tekstilit me 5.9 përqind. Ndikimi i ngritjes së çmimeve të këtyre kategorive në gjithsej çmimet e prodhimit u reduktua nga rënia e çmimeve të prodhimit të

Figura 27. Indekset e çmimeve të konsumit, prodhimit dhe importit



Burimi: ASK (2014)


metaleve prej 9.7 përqind, pastaj rënia e çmimeve të industrisë së veshjeve dhe gëzofëve prej 5.3 përqind, prodhimi i kemikaleve dhe produkteve kimike prej 4.8 përqind, etj.

Kjo rritje e çmimeve të prodhimit mund të ketë ndikuar në rënien e konkurrueshmërisë së produkteve kosovare ndaj produkteve të partnerëve tregtarë. Një gjë e tillë konfirmohet edhe nga norma reale efektive e këmbimit (NREK) të Euros në Kosovë kundrejt valutave të partnerëve tregtarë e cila bazohet në çmimet e konsumit. Gjatë vitit 2013, NREK u vlerësua për mesatarisht 0.2 përqind, që është kryesisht rezultat i inflacionit më të lartë në Kosovë se sa në vendet partnere tregtare. Sa i përket vendeve, NREK u vlerësua për 0.3 përqind ndaj vendeve të BE-së ndërsa u zhvlerësua për 0.5 përqind ndaj vendeve të CEFTA-së, gjë që nënkupton se produktet kosovare mund të kenë zvogëluar konkurrueshmërinë ndaj vendeve të BE-së dhe rritur ndaj vendeve të CEFTA-s.

4.3.3 Çmimet e Patundshmërisë


Gjatë vitit 2013, Banka Qendrore e Republikës së Kosovës ka përpiluar bazën e të dhënave me të dhënat historike mbi çmimin e patundshmërisë në Kosovë sipas listimit për shitje nga pronarët. Nga kjo databazë, është kompletuar seria prej 8 viteve, pra për periudhën 2006-2012. Gjatë këtij viti pritet që të përditësohen informatat edhe për vitin 2013. Për më tepër, në proces është edhe përpilimi i indeksit të çmimeve të patundshmërisë si një ndër treguesit e rëndësishëm për stabilitet financiar dhe makroekonomik. Të dhënat në figurën 28 paraqesin çmimin e listuar për qytetin e Prishtinës, që nuk nënkupton domosdo çmimin final të shitjes, por çmimi i kërkuar nga shitësi. Marrë parasysh dallimet strukturore në matjen e sipërfaqes së apartmenteve nga ndërtuesit e rinj në krahasim me ato që cilësohen si ndërtime të vjetra, është vlerësuar se çmimi duhet të paraqitet ndaras për dy kategoritë. Siç edhe është paraqitur në figurën 29, deri në vitin

Figura 28. Mesatarja e thjeshtë e çmimeve të listuara për apartamente në Prishtinë, EUR/metër



Burimi: Oferta Suksesi (2013) dhe kalkulime të BQK-së

Figura 29. Financimi i patundshmërisë nga sistemi bankar dhe investimet e huaja direkte, në milionë



Burimi: BQK (2014)


2012, çmimet e patundshmërisë në përgjithësi kanë pasur tendencë rritëse, rritje kjo e cila më tepër ka ndodhur te çmimet e ndërtimeve të vjetra. Ndërsa, çmimi i ndërtimeve të reja është karakterizuar me tendencë të lehtë rënëse, që kryesisht i atribuohet rritjes së ofertës nga kjo kategori. Përveç rritjes së ofertës, kreditë për blerje të patundshmërisë kanë shënuar rënie të lehtë gjatë viteve 2011-2013 që gjithashtu mund të ketë ndikuar në rënie të çmimit të patundshmerive, sidomos për ndërtimet e reja (figura 29). Përkundër rënies së kreditimit bankar për blerje të patundshmerive, gjatë periudhës 2011-2013 janë rritur në masë të konsiderueshme blerjet e patundshmerive nga jo-rezidentët, që kryesisht përbëhen nga diaspora kosovare (figura 29).

Në anën tjetër, bankat presin që në gjashtmuorin e parë të vitit 2014 kërkesa për kredi për blerje të patundshmërive të rritet në masë të konsiderueshme që rrjedhimisht pritet të rrisë financimin e këtij tregu (Figura 30).

4.3.4. Sektori i jashtëm

Stabilizimi gradual i ekonomive të eurozonës, sidomos në pjesën e dytë të vitit 2013, si dhe ngritja e çmimeve të produkteve kryesore në tregjet ndërkombëtare janë përkthyer në përmirësim të pozicionit të neto eksporteve në vend në vitin 2013. Duke zbritur në nivelin më të ulët të shënuar që nga viti 2007, raporti i deficitit të llogarisë rrjedhëse ndaj PBB-së në vitin 2013 ishte 6.4 përqind (7.5 përqind të PBB-së në vitin 2012). Rënia e deficitit në llogarinë rrjedhëse ishte kryesisht rezultat i zvogëlimit të deficitit tregtar, gjegjësisht rritjes së eksporteve dhe zvogëlimit të importeve në vitin 2013. Rritja e kërkesës së jashtme, sidomos në vendet e rajonit dhe në disa nga vendet e eurozonës, është reflektuar në rritjen e eksporteve të Kosovës në vitin 2013 krahasuar me vitin paraprak. Gjithashtu, zhvlerësimi i Normës Reale Efektive të Këmbimit (angl. Real Effective Exchange Rate: REER) në vitin 2013 krahasuar me vitin paraprak mund të ketë ndikuar deri në një masë në rritjen e konkurrueshmërinë së mallrave të Kosovës kundrejt vendeve të rajonit. Në vitin 2013, importet u karakterizuan me rënie, që deri në një masë mund ti atribuohet zëvendësimit të një pjese të mallrave të importit me prodhim vendor dhe rënies së çmimeve të produkteve kryesore që importohen në Kosovë, sidomos naftës. Me bilanc pozitiv vazhduan të karakterizohen kategoritë e shërbimeve, të ardhurave dhe transfereve rrjedhëse, përderisa rritja e flukseve në llogarinë kapitale dhe financiare përforcoi qëndrueshmërinë e financimit të deficitit të llogarisë rrjedhëse.

Figura 30. Pritjet e bankave mbi kërkesen per kredi nga ndermarrjet dhe rritja e kredive ndaj ndermarrjeve




*Që nga viti 2014, anketa realizohet për periudhën gjashtë mujore.
Burimi: BQK (2014)

4.4.1 Llogaria rrjedhëse

Bilanci i llogarisë rrjedhëse vazhdon të ndikohet negativisht nga defciti tregtar që karakterizon sektorin e jashtëm të Kosovës, përderisa bilanci i qëndrueshëm pozitiv i kategorisë së shërbimeve, të ardhurave dhe transfereve rrjedhëse vazhdon të kundërveprojë duke kontribuar në zvogëlimin e shkallës së deficitit të llogarisë rrjedhëse. Në vitin 2013, defciti në llogarinë rrjedhëse arriti vlerën prej 339.4 milion euro, që paraqet një rënie prej 10.7 përqind krahasuar me vitin paraprak. Ngushtimi i deficitit të llogarisë rrjedhëse gjatë kësaj periudhe ishte kryesisht rezultat i zvogëlimit të deficitit tregtar që rezultoi nga rritja e vlerës së eksporteve dhe rënia e vlerës së importeve, përderisa të gjitha kategoritë tjera në kuadër të bilancit të llogarisë rrjedhëse vazhduan të karakterizohen me bilance pozitive.

Figura 31. Bilanci i llogarisë rrjedhëse, në milionë euro



Burimi: BQK (2014)

Megjithatë, pjesëmarrja e eksporteve të Kosovës në gjithsej PBB vijon të mbetet e ulët prej vetëm 5.7 përqind në vitin 2013, përderisa importet vazhdojnë të kenë një pjesëmarrje të lartë në gjithsej PBB prej rreth 43.1 përqind. Në kuadër të strukturës së importeve, pjesëmarrja e mallrave kapitale mbetet e ulët. Gjithashtu, në vitin 2013 krahasuar me vitin paraprak, ka pasur indikacione se importi i mallrave të ndërmjetme është zvogëluar përderisa importi i mallrave për konsum gjatë kësaj periudhe është rritur. Përmirësimi i qëndrueshëm i llogarisë rrjedhëse në periudhat në vazhdim kushtëzohet jo vetëm nga rritja e nivelit të kapaciteteve prodhuese, por edhe nga rritja e vazhdueshme e konkurrueshmërisë së prodhimit vendor si brenda vendit, ashtu edhe në tregun e jashtëm. Me rritjen e vazhdueshme të kapaciteteve prodhuese dhe përpunuese të industrisë së metaleve, eksportet e kësaj kategorie priten të vazhdojnë të rriten, duke zbutur kështu ndjeshmërinë që kanë eksportet e vendit ndaj ndryshimeve të çmimeve në tregjet ndërkombtare të produkteve që Kosova eksporton.


Mallrat dhe shërbimet

Në vitin 2013, aktiviteti tregtar i vendit u karakterizua me rritje të vlerës së eksporteve dhe rënie të vlerës së importeve. Deficiti tregtar i Kosovës në vitin 2013 ishte më i ulët për 2.5 përqind krahasuar me vitin 2012 dhe kishte vlerën prej 1.68 miliard euro. Rënia e importeve të mallrave dhe shërbimeve gjatë vitit 2013 krahasuar me vitin paraprak, si dhe rritja e lehtë e eksporteve të mallrave dhe shërbimeve gjatë kësaj periudhe ka ndikuar që shkalla e hapjes tregtare të shënoj rënie. Në vitin 2013, shkalla e hapjes tregtare, gjegjësisht raporti i aktivitetit tregtar të Kosovës ndaj PBB-së zbriti në rreth 68.0 përqind, nga 69.9 përqind sa ishte në vitin paraprak.

Mallrat


Deficiti i shënuar në llogarinë e mallrave shënoi vlerën 1.99 miliard euro në vitin 2013, që paraqet një rënie prej 3.9 përqind krahasuar me vitin 2012. Rritja më e shpejtë e vlerës së mallrave të eksportuara nga Kosova kundrejt mallrave të importuara në vend ka ndikuar që raporti i mbulimit të importeve nga eksportet të rritet në 13.3 përqind nga 12.2 përqind sa ishte në vitin

Figura 32. Importet, eksportet dhe bilanci tregtar,




Burimi: ASK (2014)

Figura 33. Gjithsej eksportet (jo kumulative) dhe çmimet ndërkombëtare të metaleve



Burimi: BQK (2014) dhe Bloomberg

Figura 34. Gjithsej importet (jo kumulative) dhe çmimet ndërkombëtare të naftës dhe ushqimit




Burimi: BQK (2014) dhe IFS dhe FAOUN

paraprak. Gjithsej eksportet e Kosovës arritën vlerën prej 293.9 milionë euro në vitin 2013, duke treguar kështu një rritje vjetore prej 6.5 përqind (13.5 përqind rënie vjetore në vitin 2012). Përderisa rënia e eksporteve të mallrave në vitin 2012 iu atribuua kryesisht rënies së përgjithshme të kërkesës në rajon dhe në vendet e BE-së dhe rënies së çmimeve të komponentëve kryesor që Kosova eksporton, në vitin 2013 ishte pikërisht këta dy faktor që ndikuan në rritjen e eksporteve të mallrave. Eksportet e vendit shënuan rritje vjetore prej 3.8 përqind në terma real⁴, rritje kjo më e ulët krahasuar me rritjen nominale. Rritja më e lartë e eksporteve në terma nominal kryesisht i atribuohet rritjes që kishin çmimet e disa prej produkteve minerale që Kosova eksportoiti gjatë vitit 2013.

Eksportet e Kosovës vazhdojnë të dominohen nga kategoria e metaleve bazë, e cila shënoi rënie të lehtë në vitin 2013 kryesisht për shkak të rënies së çmimeve të metaleve gjatë kësaj periudhe. Përndryshe, eksportet e produkteve minerale, pijeve dhe duhanit, produkteve të gomës, plastikës dhe të tjera, si dhe produktet bujqësore gjatë kësaj periudhe shënuan rritje. Në vitin 2013, rritja e eksporteve në Kosovë u mbështet kryesisht në rritjen e eksporteve të koncentratit të zinkut dhe plumbit dhe të energjisë elektrike, të cilat kategorizohen në kuadër të produkteve minerale. Gjithashtu, në vitin 2013 kishte indikacione për rritje të prodhimit vendor dhe zavendësim të disa mallrave të importuara me eksport. Në këtë kontekst, rritja e vlerës së eksporteve të produkteve bujqësore, eksporteve të letrës dhe artikujve të letrës, eksporteve të produkteve ushqimore si mielli dhe sheqeri gjatë vitit 2013, kundrejt rënies së vlerës së importeve të këtyre kategorive mund të jetë indikacion për rritjen e prodhimit vendor në këto kategori dhe zavendësimin potencial të këtyre mallrave paraprakisht të importuara me eksport.


Në vitin 2013, vlera e gjithsej mallrave të importuara në Kosovë ishte 2.45 miliard euro, që paraqet një rënie vjetore prej 2.3 përqind. Në terma real, importet kanë shënuar rënie vjetore prej 2.9 përqind në vitin 2013. Rënia e sasisë së mallrave të importuara në vitin 2013 krahasuar me vitin paraprak jap indikacion për zvogëlim të kërkesës nga disa sektorë të ekonomisë. Rënia e importeve të makinerive, paisjeve mekanike dhe elektrike si dhe rënia e importeve të mjeteve të transportit jep indikacione për ngadalësim të aktivitetit ekonomik në sektorin e industrisë përpunuese gjatë vitit 2013. Rënia e importeve në vitin 2013 u nxit edhe nga rënia e çmimeve të derivateve të naftës, gjë që u reflektua në zvogëlimin e vlerës së

Figura 35. Struktura e eksporteve dhe importeve sipas shteteve, në përqindje



Burimi: BQK (2014)

Figura 36. Struktura e neto eksportit të shërbimeve, në milionë euro



Burimi: BQK (2014)

⁴ Për llogaritjen e eksporteve dhe importeve në terma real, janë përdorur Indeksi i Çmimeve të Importit (IPI) dhe Indeksi i çmimeve të prodhimit PPI të publikuara nga ASK.

importeve të produkteve minerale, që njëherësh kanë pjesëmarrjen më të lartë në kuadër të gjithsej importeve të Kosovës.

Partnerët kryesor tregtarë të Kosovës vazhdojnë të jenë shtetet e BE-së. Importet me origjinë nga BE-ja përfaqësojnë 40 përqind të gjithsej vlerës së importeve të Kosovës. Në vitin 2013, pjesa më e madhe e importeve ka ardhur nga Gjermania, Italia dhe Greqia. Në kuadër të vendeve tjera evropiane dhe vendeve nga Azia, Kosova importon sasi të konsiderueshme të mallrave nga Turqia dhe Kina. Ndërkaq, në kuadër të vendeve të rajonit, pjesa më e madhe e importeve të Kosovës vjen nga Serbia dhe Maqedonia. Në anën tjetër, eksportet e Kosovës në vendet e BE-së përfshijnë rreth 44 përqind të gjithsej eksporteve të Kosovës, të përqendruara kryesisht në Itali dhe një pjesëmarrje më e vogël në Gjermani. Sa i përket vendeve të rajonit, Kosova vazhdon të eksportojë më shumë në Shqipëri, Mal të Zi dhe Maqedoni. Një pjesëmarrje e konsiderueshme e eksporteve të Kosovës ka për destinacion edhe Indinë dhe Turqinë. Kosova importon produktet minerale kryesisht nga Italia dhe Greqia, përderisa nga Gjermania importon makineri, paisje mekanike dhe elektrike, mjete të transportit, produkte të plastikës, duhan etj. Nga vendet e rajonit, konkretisht Serbia dhe Maqedonia, Kosova importon kryesisht produkte minerale, paisje mekanike dhe elektrike, produkte të qeramikës, pije dhe produkte ushqimore, etj. Produktet e hekurit dhe çelikut, paisjet mekanike dhe elektrike, produktet e qeramikës, tekstilit, etj importohen nga Turqia dhe Kina. Sa i përket eksporteve të vendit, Kosova kryesisht eksporton në Itali hekur dhe çelik, produkte të bakrit, produkte të lëkurës, etj. Në Shqipëri, eksportohet hekur dhe çelik dhe artikuj të tyre, metale bazë, produkte të plastikës, pije, produkte minerale, etj. Në Mal të Zi dhe Maqedoni, Kosova eksporton kryesisht metale bazë, duhan, produkte të tekstilit, artikuj të ndryshëm të prodhuar, artikuj të letrës, artikuj të gurit dhe qeramikës, etj.

Shërbimet

Llogaria e tregtisë së shërbimeve kishte bilanc pozitiv edhe në vitin 2013, por për dallim nga vitet paraprake, bilanci i kësaj llogarie shënoi një rënie. Zvogëlimi i bilancit të llogarisë së shërbimeve në këtë periudhë kryesisht reflekton rënien e të hyrave nga shitja e shërbimeve të jorezidentët, krahasuar me rritjen që shënuan pagesat e rezidentëve Kosovar ndaj jo rezidentëve. Në vitin 2013, bilanci i shërbimeve kishte vlerën prej 308.4 milionë euro, një zvogëlim krahasuar me bilancin e vitit paraprak prej 346.2 milionë euro në vitin 2012. Llogaria e shërbimeve realizoi të hyra në vlerë prej 622.0 milionë euro, një rënie vjetore prej 2.1 përqind. Në të njëjtën kohë, gjithsej pagesat për shërbimet e blera nga jashtë arritën vlerën prej 313.7 milionë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 8.6 përqind. Në kuadër të shërbimeve, rënien më të madhe e shënuan shërbimet e udhëtimit, shërbimet e telekomunikacionit dhe shërbimet qeveritare.

Kategoria kryesore në bilancin e shërbimeve vazhdon të jetë kategoria e udhëtimit, që kryesisht përbëhet nga shitja e shërbimeve për jo-rezidentët. Në vitin 2013, bilanci i llogarisë së shërbimeve të udhëtimit arriti në 306.0 milionë euro, që krahasuar me vitin paraprak paraqet një rënie vjetore prej 1.1 përqind. Eksporti i shërbimeve të udhëtimit u karakterizua me rritje në vitin 2013, megjithëse rritja ishte më e theksuar te importet e shërbimeve të udhëtimit, duke u reflektuar kështu edhe në bilancin e përgjithshëm të këtyre shërbimeve. Të hyrat nga shërbimet e udhëtimit arritën vlerën prej 406.5 milion, një rritje vjetore prej 6.3 përqind, dhe kryesisht përbëhen prej shpenzimeve të jorezidentëve gjatë qëndrimit në Kosovë. Në të njëjtën kohë, pagesat për shërbimet e udhëtimit (kryesisht udhëtime të rezidentëve kosovar për pushime verore) arritën vlerën prej 100.6 milion euro, që paraqet një rritje vjetore prej 37.7 përqind.

Bilanci i shërbimeve të komunikimit në vitin 2013 kishte vlerën prej 33.1 milionë euro (48.3 milionë euro në vitin 2012), përderisa bilanci i shërbimeve qeveritare kishte vlerën prej 23.2 milionë euro (30.9 milion euro në vitin 2012). Në vitin 2013, bilanci i shërbimeve të komunikimit u zvogëlua kryesisht si pasojë e zvogëlimit të aktivitetit të kompanive të komunikimit në


ekonominë e Kosovës. Gjithashtu, shërbimet për qeverinë, që paraqesin kryesisht shërbimet e ofruara ndaj prezencës ndërkombëtare në Kosovë siç janë misionet diplomatike dhe prezenca e institucioneve tjera ndërkombëtare si Eulex dhe KFOR), u zvogëluan në vitin 2013 krahasuar me vitin paraprak kryesisht pasojë e zvogëlimit të prezencës së stafit në institucionet ndërkombëtare në vend. Në të njëjtën kohë, pagesat për rezidentët Kosovar në misionet diplomatike u rritën.

Të ardhurat dhe transferet rrjedhëse

Llogaria e të ardhurave kishte bilanc pozitiv prej 121.8 milionë euro në vitin 2013, edhe pse më të ulët krahasuar me bilancin e vitit paraprak prej 154.1 milionë euro. Bilanci pozitiv në llogarinë e të ardhurave u zvogëlua në vitin 2013 krahasuar me vitin paraprak kryesisht si pasojë e rritjes së pagesave dhe rënies së të hyrave në kuadër të të ardhurave nga investimet. Në kuadër të llogarisë së të ardhurave, në vitin 2013 të hyrat u zvogëluan në 227.7 milionë euro, që paraqet një rënie vjetore prej 1.2 përqind. Në anën tjetër, pagesat u rritën për 43.6 përqind, duke arritur vlerën prej 101.6 milionë euro. Të hyrat nga kompensimi i punonjësve, që kryesisht përbëhet nga të ardhurat e punonjësve jashtë vendit siç janë punëtorët sezonal si dhe punonjësit në Afganistan dhe Irak është edhe kategoria më e madhe në kuadër të të hyrave të llogarisë së të ardhurave. Në vitin 2013, të hyrat nga kompensimi i punonjësve arritën vlerën prej 223.2 milionë euro (219.9 milionë euro në vitin 2012). Në të njëjtën kohë, pagesat për kompensimin e punëtorëve, që kryesisht përfshijnë punëtorët jorezident të angazhuar në Kosovë për periudhë më pak se një vit, shënuan vlerën 4.3 milionë euro në vitin 2013 krahasuar me 5.6 milionë euro sa ishin në vitin 2012.


Të ardhurat nga investimet kishin një bilanc negativ prej 97.1 milionë euro në vitin 2013 (60.1 milion euro në vitin 2012). Të hyrat në kuadër të të ardhurave nga investimet u zvogëluan në 4.5 milionë euro në vitin 2013 (10.6 milion euro në vitin 2012), përderisa pagesat rritën vlerën në 101.6 milion në të njëjtën periudhë (70.8 milionë euro në vitin 2012). Të hyrat nga investimet përbëhen kryesisht nga të ardhurat që janë realizuar nga investimet e institucioneve vendore (letra me vlerë, depozita, etj.) në tregjet e jashtme, ndërkaq pagesat përbëhen kryesisht nga të ardhurat e realizuara nga investimet e kompanive të huaja që veprojnë në vend si bankat komerciale dhe ndërmarrjet e huaja që operojnë në vend. Në këtë kontekst, të hyrat nga investimet në vitin 2013 u zvogëluan kryesisht si pasojë e zvogëlimit të të hyrave nga investimet e BQK-së në tregjet e jashtme, konkretisht nga investimet në depozita. Ndërkaq, rritja e

Figura 37. Transferet rrjedhëse, në milionë euro



Burimi: BQK (2014)

Figura 38. Pranimet e remitencave



Burimi: BQK (2014)

pagesave në të ardhurat nga investimet kryesisht i atribuohet rritjes së fitimit të riinvestuar nga kompanitë në vitin 2013.

Transferet rrjedhëse vazhdojnë të përfaqësojnë një kategori me rëndësi të veçantë në bilancin e pagesave në Kosovë, duke i kontribuar në vazhdimësi zbutjes së deficitit të llogarisë rrjedhëse. Në vitin 2013, bilanci i llogarisë së transfereve rrjedhëse arriti vlerën prej 1.2 miliard euro, që paraqet një rritje vjetore prej 2.4 përqind (figura 7). Struktura e transfereve rrjedhëse dominohet nga transferet e sektorit privat (72.0 përqind) dhe nga transferet qeveritare (28.0 përqind). Vlera e transfereve qeveritare u zvogëlua në 341.9 milionë euro në vitin 2013, gjegjësisht një rënie vjetore prej 14.8 përqind. Në kuadër të transfereve rrjedhëse qeveritare kryesisht hyjnë transferet e donatorëve, EULEX-it dhe UNMIK-ut.

Transferet rrjedhëse të sektorit privat dominohen kryesisht nga remitencat, bilanci neto i të cilave përfaqëson rreth 62.7 përqind të gjithsej transfereve të sektorit privat. Remitencat e pranuar në Kosovë arritën vlerën prej 620.8 milionë euro në vitin 2013, që paraqet një rritje vjetore prej 2.5 përqind (Figura 8). Remitencat që pranohen në Kosovë vijnë kryesisht nga Gjermania dhe Zvicra, vende këto nga të cilat dërgohen 33 përkatësisht 24 përqind të gjithsej remitencave të pranuar në Kosovë. Një pjesë e konsiderueshme e remitencave dërgohet edhe nga Italia dhe Austria, që kanë pjesëmarrje prej 7 përkatësisht 6 përqind në gjithsej remitencat e pranuar në Kosovë. Sa i përket kanaleve të transferimit të remitencave në vend, rreth 21.2 përqind transferohen përmes sistemit bankar, ndërsa 35.2 përqind transferohen përmes agjensioneve për transferimin e parave. Pjesa e mbetur e dërgesave transforehen përmes kanaleve të tjera që përfshijnë edhe kanalet joformale. Në anën tjetër, dërgesat e jorezidentëve në Kosovë drejtë vendeve tjera shënuan vlerën prej 68.8 milionë euro (86.1 milionë euro në vitin 2012).

4.4.2 Llogaria financiare

Bilanci i llogarisë financiare në vitin 2013 arriti vlerën prej 123.5 milionë euro krahasuar me 130.3 milionë euro në vitin 2012. Asetet shënuan rritje për 205.1 milionë euro, që krahasuar me vitin 2012 janë për 36.4 përqind më të ulëta, ndërsa detyrimet arritën vlerën prej 328.6 milionë euro që krahasuar me vitin 2012 janë për 27.4 përqind më të ulëta. Kontribuuesi kryesor në kuadër të bilancit pozitiv të llogarisë financiare vazhdon të jetë kategoria e investimeve të huaja direkte (IHD), ndërsa ndikim negativ në bilancin e llogarisë financiare vazhdon të ketë rritja e vazhdueshme e investimeve portfolio jashtë ekonomisë së Kosovës (tabela 3).

Tabela 3. Llogaria financiare, në milionë euro

Përshkrimi	2008	2009	2010	2011	2012	2013
LLOGARIA FINANCIARE	288.5	109.0	275.9	376.8	130.3	123.5
<i>Asetet</i>	227.8	230.6	402.9	93.9	322.3	205.1
Investimet e huaja direkte (dalëse)	25.0	10.5	34.7	15.7	15.8	17.9
Investimet portfolio	109.9	124.8	48.6	57.8	185.7	139.3
Investimet tjera	74.7	190.1	266.2	81.7	-146.3	83.5
Asetet rezerve	18.2	-94.8	53.4	-61.2	267.2	-35.7
<i>Detyrimet</i>	516.3	339.7	678.7	471.4	452.7	328.6
Investimet e huaja direkte (hyrëse)	366.5	287.4	365.8	393.9	229.1	259.4
Investimet portfolio	0.0	0.5	-0.7	0.8	0.7	-1.0
Investimet tjera	149.8	51.8	313.6	76.0	222.9	70.2

Burimi: BQK (2014)

Investimet e Huaja Direkte


Gjatë vitit 2013, Investimet e Huaja Direkte (IHD) të pranuar në Kosovë shënuan rritje për 13.3 përqind apo arritën vlerën prej 259.4 milionë euro. Investimet e rezidentëve të Kosovës në vende tjera shënuan rritje prej 13.5 përqind dhe arritën vlerën prej 17.9 milionë euro. Investimet direkte të rezidentëve kosovarë jashtë ekonomisë së Kosovës janë kryesisht investime kapitale, të cilat në të shumtën e rasteve janë blerje e patundshmërive.

Si rezultat i krizës globale financiare por edhe procesit më të ngadalshëm të privatizimit, IHD-të në raport me PBB-në kanë shënuar rënie të vazhdueshme që nga viti 2008. Ndërkohë, në vitin 2013 është shënuar përmirësim i këtij treguesi nga 4.5 përqind të PBB-së në vitin 2012 në 4.9 përqind të PBB-së në vitin 2013 (figura 39). Në kudër të IHD-ve, rritje ka shënuar kategoria e kredive ndërmjet ndërmarrjeve dhe fitimi i ri-investuar⁵ (65.7 përkatësisht 25.7 milionë euro më shumë se sa në vitin 2012), ndërsa kapitali aksionar ishte për 61.0 milionë euro më i ulët se sa në vitin 2012.

Siç edhe është paraqitur në figurën 40, IHD-të në patundshmëri, të cilat kryesisht janë kapital aksionar, kanë shtuar dominimin në strukturën e gjithsej IHD-ve edhe gjatë vitit 2013. Me rritje janë karakterizuar edhe sektori i transportit dhe telekomunikacionit, shërbimeve financiare, energjetikës dhe tregtisë, ndërsa IHD-të në sektorin e ndërtimitarisë dhe prodhimit kanë shënuar rënie.


Sa i përket origjinës së IHD-ve, Turqia paraqet vendin prej nga vjen pjesa më e madhe e IHD-ve në Kosovë (33.6 përqind e gjithsej IHD-ve), pasuar nga Zvicra (16.1 përqind), Gjermania (8.4 përqind), Shqipëria (7.9 përqind), etj. Përderisa investimet nga Turqia kanë shënuar rritje prej 32.3 përqind gjatë vitit 2013, investimet nga Gjermania dhe Zvicra kanë shënuar rënie për 56.2 përkatësisht 4.8 përqind. Gjithashtu, vlen të theksohet se vërehet një interesim i shtuar i investitorëve nga Shqipëria për të investuar në Kosovë. Vetëm në vitin 2013 IHD-të nga Shqipëria janë trefishuar krahasuar me vitin 2012 dhe kanë arritur vlerën prej 20.5 milionë euro (4.7 milionë euro në vitin 2012).

Figura 39. Investimet e huaja direkte, në milionë euro dhe si përqindje e PBB-së



Burimi: BQK (2014)

Figura 40. Investimet e huaja direkte sipas sektorëve kryesor ekonomik, në përqindje



Burimi: BQK (2014)

⁵Fitimi i ri-investuar është pjesa e fitimit e cila nuk shpërndahet në formë të dividendës por investohet prapë në kompani, ndërsa kreditë ndërmjet ndërmarrjeve paraqesin huamarrjet të cilat i bëjnë ndërmarrjet investuese direkte në Kosovë nga investitorët direkt.

Portfolio investimet, investimet tjera dhe asetet rezervë

Bilanci i investimeve portfolio gjatë vitit 2013 ishte -140.3 milionë euro (-184.9 milionë euro në vitin 2012). Investimet portfolio jashtë vendit, kryesisht në letra me vlerë të borxhit, shënuan vlerën prej 139.3 milionë euro (185.7 milionë euro në 2012). Viti 2012 ishte karakterizuar me një ndryshim substancial të formës së investimeve, nga depozita në investime portfolio. Ky ndryshim i formës së investimeve ka bërë që bilanci i investimeve portfolio të jetë më i ulët në vitin 2013 krahasuar me vitin 2012. Pjesa më e madhe e investimeve portfolio përbëhen nga investimet e fondeve pensionale në instrumente të ndryshme financiare jashtë vendit, ndërsa pjesa tjetër i takon Bankës Qendrore dhe bankave komerciale.


Kategoria e investimeve tjera në vitin 2013 u karakterizua me zvogëlim substancial të bilancit. Nga 369.2 milionë euro sa ishte në vitin 2012, bilanci i kësaj kategorie u zvogëluar në 13.4 milionë euro në vitin 2013. Bilanci kaq i lartë pozitiv i investime të tjera në vitin 2012 kryesisht reflekton tërheqjen e depozitave jashtë vendit nga BQK-ja (kryesisht asete që menaxhohen në emër të fondit pensionale) por edhe rritjes së kredive tregtare. Kjo tërheqje e depozitave paraqet hyrje të kapitalit brenda vendit gjë që kontribuon pozitivisht në bilancin e kësaj kategorie. Në të njëjtin vit, këto mjete janë investuar jashtë vendit në formë të investimeve portofolio nga vetë fondi pensional. Në anën tjetër, bilanci shumë më i ulët i investimeve tjera në vitin 2013 kryesisht reflekton faktin se në vitin 2013 nuk pati një tërheqje të depozitave ngjashëm me vitin 2012. Gjithashtu, shtrëngimi i kredidhënies nga bankat komerciale në Kosovë dhe rritja pasuese e investimeve jashtë vendit ndikoj në rënien e bilancit të investimeve tjera. Përveç kësaj në vitin 2013 u shënuar rënie e konsiderueshme e kredive tregtare. Konkretisht, në vitin 2013 depozitat e investuara jashtë u rritën për 60.5 milionë euro ndërsa kreditë tregtare u zvogëluar nga 100.3 milionë euro në vitin 2012 në 19.1 milionë euro në vitin 2013 që lidhet edhe me nivelin më të ulët të importeve.

Asetet rezervë, të cilat janë të investuara kryesisht në instrumente të tregut të parasë dhe në depozita, gjatë vitit 2013 janë zvogëluar për 35.7 milionë euro. Megjithatë, duke pasur parasysh faktin se në Kosovë përdoret Euro si valutë zyrtare, e cila është e pranueshme në çdo transaksion ndërkombëtar, mund të konsiderohet se asetet rezervë në Kosovë nuk kanë rëndësi të madhe në krahasim me shumicën e vendeve tjera.

4.4.3 Pozicioni ndërkombëtar i investimeve

Pozicioni ndërkombëtar i investimeve (PNI)⁶ neto në fund të vitit 2013 ishte pozitiv me vlerë prej 400.4 milionë euro (figura 41). Bilanci pozitiv i PNI-së ka ndjekur trend rënës deri në vitin 2011, ku si përqindje e PBB-së kishte arritur në 2.8 përqind, ndërsa ka filluar të rritet përsëri dhe ka arritur në 7.5 përqind të PBB-së në vitin 2013. Në rritjen e bilancit të PNI-së ndikuan investimet portfolio neto dhe investimet tjera duke shënuar rritje vjetore prej 20.2 përkatësisht 23.8 përqind në vitin 2013. Në anën tjetër, bilanci i investimeve

Figura 41. Pozicioni ndërkombëtar i investimeve, në miliardë euro



Burimi: BQK (2014)

⁶PNI paraqet gjendjen në fund të një periudhe të caktuar kohore të aseteve dhe detyrimeve të jashtme financiare. Gjendja në fund të periudhës është rezultat i gjithë transaksioneve që rrjedhin nga e kaluara, përfshirë edhe korrigjimet si pasojë e lëvizjeve në kursin e këmbimit për të llogaritur vlerën e mjeteve/detyrimeve financiare në ditën e raportimit apo ndryshimet në çmimin e tregut. Bilanci pozitiv i PNI-së nënkupton se shuma e mjeteve të investuara nga Kosova jashtë vendit është më e madhe se sa shuma e mjeteve të investuara nga shtetet tjera në Kosovë.

direkte vazhdoi të jetë negativ dhe shënoi rritje prej 9.6 përqind në vitin 2013.

Sa i përket sektorëve institucional, Banka Qendrore dhe bankat komerciale kanë pasur në vazhdimësi bilanc pozitiv (1.5 miliardë përkatësisht 539.6 milionë euro në vitin 2013), ndërsa sektorët tjerë⁷ dhe qeveria bilanc negativ (1.3 miliardë përkatësisht 321.8 milionë euro) (figura 42).

Stoku i aseteve në fund të vitit 2013 arriti në 4.1 miliardë euro (rritje vjetore prej 10.4 përqind). Rritjes së aseteve më së shumti i kanë kontribuar investimet portfolio të cilat shënuan rritje prej 20.9 përqind dhe investimet tjera të cilat shënuan rritje prej 11.5 përqind. Investimet portfolio, të cilat kanë një pjesëmarrje të konsiderueshme në stokun e aseteve jashtë vendit (29.2 përqind), janë investuar kryesisht në letra me vlerë të borxhit (65.8 përqind), ndërsa pjesa tjetër (34.2 përqind) në letra me vlerë të kapitalit.


4.4.4 Borxhi i jashtëm

Në vitin 2013, Kosova kishte bilanc neto pozitiv të borxhit të jashtëm në vlerë prej 1.9 miliardë euro, që do të thotë se borxhi i sektorit të jashtëm ndaj ekonomisë së Kosovës (3.5 miliardë euro) është më i lartë se sa borxhi i ekonomisë së Kosovës ndaj sektorit të jashtëm (1.6 miliardë euro).

Borxhi i jashtëm i Kosovës, i cili përfshinë borxhin e jashtëm privat dhe borxhin e jashtëm publik⁸, në vitin 2013 arriti në 1.6 miliardë euro që është për 5.1 përqind më i lartë se sa në vitin 2012. Si përqindje e PBB-së, borxhi i jashtëm bruto prej 31.0 përqind në vitin 2013 ishte pothuajse i njëjtë me vitin paraprak (figura 43). Edhe borxhi i jashtëm publik ka një pjesëmarrje të ulët në gjithsej borxhin e jashtëm bruto, çka reflekton nivelin e ulët të borxhit të përgjithshëm publik në Kosovë krahasuar me vendet tjera të rajonit (383.9 milionë euro apo 24.1 përqind e borxhit të jashtëm bruto).


Pjesa më e madhe e borxhit të jashtëm përbëhet nga huat ndërmjet kompanive (figura 44). Kompanitë e huaja që operojnë në Kosovë i detyrohen sektorit të jashtëm me 672.6 milionë euro apo 42.2 përqind të gjithsej borxhit të jashtëm. Me pjesëmarrje të konsiderueshme në gjithsej borxhin e jashtëm të Kosovës janë edhe sektorët tjerë (329.7 milionë euro ose 20.7 përqind e gjithsej borxhit të jashtëm).

Figura 42. Pozicioni ndërkombëtar i investimeve neto sipas sektorëve institucional, në miliardë euro



Burimi: BQK (2014)

Figura 43. Borxhi i jashtëm bruto, në milionë euro




Burimi: BQK (2014)

⁷ Në kuadër të sektorëve tjerë përfshihen: fondet pensionale, ndihmësit financiar, kompanitë e sigurimeve, organizatat joqeveritare, kompanitë private, dhe individët.

⁸ Në kuadër të borxhit publik përfshihet borxhi i qeverisë dhe bankës qendrore, ndërsa në kuadër të borxhit privat përfshihen huat ndërmjet kompanive, sistemin bankar, dhe sektorët tjerë.

Borxhi i jashtëm i qeverisë në vlerë prej 321.8 milionë euro është kryesisht borxh i trashëguar që nënkuptohet se është borxh afatgjatë dhe përbën 20.2 përqind të gjithë borxhit të jashtëm bruto. Stoku i borxhit të jashtëm bruto i sistemit bankar në shtator 2013 ishte 208.1 milionë euro ose 13.1 përqind e gjithë borxhit të jashtëm. Ky borxh është afatshkurtër dhe pjesën më të madhe të tij e përbëjnë depozitat e jo-rezidentëve. Me pjesëmarrjen më të ulët në gjithë borxhin e jashtëm është Banka Qendrore (62.1 milionë euro apo 3.9 përqind e gjithë borxhit të jashtëm). Detyrimet e Bankës Qendrore i përkasin kryesisht stokut të alokimeve të Drejtave Speciale të Tërheqjes (angl. Special Drawing Rights: SDR) nga FMN-ja.

Figura 44. Borxhi i jashtëm bruto sipas sektorëve, në milionë euro




Burimi: BQK (2014)

Borxhi i sektorit të jashtëm ndaj Ekonomisë së Kosovës në fund të vitit 2013 arriti në 3.5 miliardë euro. Këto mjete kryesisht janë fonde të investuara jashtë vendit si mjetet e privatizimit dhe të Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës, të cilat kryesisht janë të investuara në formë të depozitave me 62.1 përqind, pasuar nga mjetet e investuara në instrumente të ndryshme financiare 34.2 përqind, ndërsa kreditë kanë një pjesëmarrje prej 3.7 përqind.

4.4.5 Sektori fiskal

Gjatë vitit 2013 sektori fiskal u karakterizua me rënie të lehtë të të hyrave dhe rritje të shpenzimeve. Të hyrat e përgjithshme buxhetore⁹ shënuan rënie prej 0.4 përqind dhe arritën vlerën prej rreth 1.32 miliardë euro (24.7 përqind e PBB-së). Në anën tjetër, vlera e përgjithshme e shpenzimeve buxhetore¹⁰ arriti në rreth 1.47 miliardë euro (27.6 përqind e PBB-së) që paraqet rritje vjetore prej 1.9 përqind. Rrjedhimisht, buxheti i Kosovës regjistroi deficit primar prej 152.7 milionë euro apo 2.9 përqind të PBB-së krahasuar me 2.4 përqind të PBB-së sa ishte në vitin paraprak (figura 45). Borxhi i përgjithshëm i qeverisë në fund të vitit 2013 ishte 475.7 milionë euro apo 9.1 përqind e PBB-së krahasuar me 8.4 përqind sa ishte në vitin paraprak. Përkundër ngritjes së lehtë në vitin 2013, Kosova ka nivel më të ulët të deficitit primar por edhe nivel më të ulët të borxhit të përgjithshëm të qeverisë krahasuar me vendet e rajonit. Më konkretisht, deficitin primar në vitin 2013 ishte 2.9 përqind e PBB-së (4.1 përqind mesatarja në vendet e rajonit), ndërsa borxhi i përgjithshëm i qeverisë ishte 9.1 përqind e PBB-së (52.9 përqind mesatarja në vendet e rajonit).

Figura 45. Të hyrat dhe shpenzimet buxhetore, në milionë euro



Burimi: MF dhe kalkulimet e BQK-së (2014)

⁹Në kuadër të të hyrave buxhetore nuk janë përfshirë pranimet nga grantet e përcaktuara të donatorëve, huazimet e brendshme dhe të jashtme, të hyrat nga privatizimi i distribucionit të KEK-ut.

¹⁰ Në kuadër të shpenzimeve buxhetore nuk janë përfshirë pagesat nga grantet e përcaktuara të donatorëve, pagesat e borxhit, si dhe kthimi i huazimeve nga ndërmarrjet publike trajtohet si zvogëlim i shpenzimeve buxhetore.

Përveç nivelit më ulët deficitit primar dhe ngarkesës me borxhe, Kosova ka shkallën më të ulët të ngarkesës së ekonomisë me tatime në rajon, pasi që raporti i të hyrave buxhetore dhe PBB-së në vitin 2013 ishte 24.7 përqind krahasuar me mesataren e rajonit prej 33.6 përqind. Edhe raporti i shpenzimeve buxhetore prej 27.6 përqind të PBB-së është më i ulët krahasuar me mesataren e rajonit prej 37.7 përqind.

Të hyrat buxhetore


Të hyrave buxhetore në Kosovë përbëhen kryesisht nga të hyrat tatimore, të cilat kanë një pjesëmarrje prej rreth 83.5 përqind në gjithsej të hyrat buxhetore. Nga gjithsej të hyrat tatimore, 86.0 përqind janë të hyra nga tatimet indirekte ndërsa vetëm 14.0 përqind janë të hyra nga tatimet direkte¹¹. Të hyrat vetanake përbëjnë 7.2 përqind të gjithsej të hyrave (58.8 përqind janë të komunave dhe 41.2 përqind të qeverisë qendrore), ndërsa të hyrat tjera përbëhen nga të hyrat jo-tatimore (6.0 përqind) dhe të hyrat e njëhershme (3.3 përqind).

Gjatë vitit 2013, kontributin kryesor në rënien e të hyrave buxhetore prej 0.4 përqind e kishin të hyrat vetanake të cilat shënuan rënie prej 8.9 përqind si dhe të hyrat tjera (kryesisht dividendat e ndërmarrjeve publike dhe grantet për mbështetje të buxhetit) të cilat shënuan rënie për 47.8 përqind. Në anën tjetër, të hyrat tatimore dhe të hyrat jo-tatimore shënuan rritje për 1.0 përkatësisht 11.3 përqind (figura 46).

Përveç ndarjes së lartpërmendur të hyrat buxhetore mund të klasifikohen edhe në të hyra të mbledhura brenda vendit dhe në të hyra të mbledhura në kufi. Gjatë vitit 2013, është shënuar performancë më e mirë në realizimin e të hyrave brenda vendit të cilat shënuan rritje vjetore prej 7.8 përqind dhe arritën vlerën neto prej 270.8 milionë euro. Rritja e të hyrave vendore reflekton ngritjen e efikasitetit të ATK-së në mbledhjen e të hyrave dhe lehtësimit të procedurave për deklarimin dhe pagesën e obligimeve tatimore. Gjithashtu, edhe rritja e aktivitetit ekonomik në Kosovë gjatë vitit 2013 konsiderohet të ketë kontribuar në rritjen e të hyrave vendore.


Gjatë vitit 2013, të gjitha kategoritë kryesore të të hyrave nga tatimet vendore u karakterizuan me rritje. TVSH-ja e mbledhur brenda vendit, e cila ka një pjesëmarrje prej 42.0 përqind në gjithsej të hyrat nga tatimet vendore, shënoi rritje prej 14.9 përqind dhe arriti vlerën neto prej 113.7 milionë euro. Të hyrat nga tatimi në korporata, që njëherit paraqesin edhe kategorinë e

Figura 46. Struktura e të hyrave buxhetore, në milionë euro



Burimi: MF dhe kalkulimet e BQK-së (2014)

Figura 47. Të hyrat vendore neto sipas llojeve të tatimeve, në milionë euro



Burimi: MF dhe kalkulimet e BQK-së (2014)


¹¹Në kuadër të tatimeve indirekte përfshihen: TVSH-ja e brendshme dhe TVSH-ja në importe, akciza dhe dogana, ndërsa në kuadër të tatimeve direkte përfshihen: tatimi i paragykuar, tatimi në fitim, tatimi mbi të ardhurat e korporatave, tatimi mbi të ardhurat personale, etj.

dytë më të madhe në kuadër të tatimeve vendore (23.3 përqind), shënuan rritje vjetore prej 3.0 përqind dhe arritën vlerën neto prej 63.1 milionë euro. Gjithashtu, të hyrat nga tatimi në të ardhura personale shënuan rritje vjetore prej 2.3 përqind dhe arritën vlerën neto prej 61.2 milionë euro. Në kuadër të të hyrave nga tatimet vendore, rritje shënuan edhe të hyrat nga tatimi i bizneseve individuale (7.5 përqind), të cilat arritën vlerën neto prej 27.8 milionë euro (figura 47).

Në anën tjetër, të hyrat e mbledhura nga tatimet në kufi shënuan rënie prej 1.0 përqind dhe arritën vlerën neto prej 834.1 milionë euro. Rënia e të hyrave nga tatimet e mbledhura në kufi kryesisht reflekton rënien e nivelit të importit. Përkundër rënies së lehtë në vitin 2013, të hyrat e mbledhura nga tatimet në kufi vazhdojnë të përfaqësojnë kategorinë kryesore të të hyrave tatimore (75.5 përqind e gjithsej të hyrat tatimore).

Në kuadër të të hyrave kufitare, kategoria kryesore mbetet TVSH-ja, me një pjesëmarrje prej 49.4 përqind të gjithsej të hyrave kufitare (figura 48). Në vitin 2013, të hyrat nga TVSH-ja e mbledhur në kufi u karakterizuan me rënie prej 1.6 përqind dhe arritën vlerën neto prej 411.0 milionë euro. Të hyrat kufitare nga akciza, që kanë një pjesëmarrje prej 36.2 përqind në gjithsej të hyrat kufitare, shënuan po ashtu një rënie të lehtë prej 0.7 përqind dhe arritën vlerën neto prej 300.8 milionë euro. Të hyrat nga tatimi doganor që përfaqësojnë 14.4 përqind të gjithsej të hyrave kufitare, shënuan rritje prej 1.9 përqind dhe arritën vlerën neto prej 119.5 milionë euro.

Figura 48. Të hyrat kufitare neto sipas llojeve të tatimeve, në milionë euro




Burimi: MF dhe kalkulimet e BQK-së (2014)

Të hyrat vetanake të nivelit qendror dhe atij lokal arritën vlerën prej 95.0 milionë euro, përderisa në vitin paraprak patën shënuar vlerën prej 104.3 milionë euro. Gjobat dhe tarifatat u karakterizuan me rritje prej 7.6 përqind dhe arritën vlerën prej 42.9 milionë euro. Zëra tjerë të rëndësishëm në kuadër të të hyrave të realizuara buxhetore në vitin 2013 ishin edhe tantimatat të cilat arritën vlerën prej 24.7 milionë euro dhe dividendat nga ndërmarrjet publike që arriti vlerën prej 43.0 milionë euro.

Shpenzimet buxhetore

Në vitin 2013, vlera e përgjithshme e shpenzimeve buxhetore arriti në rreth 1.5 miliardë euro, që paraqet rritje vjetore prej 1.9 përqind. Shpenzimet rrjedhëse të cilat përbëhen nga pagat dhe mëditjet, mallrat dhe shërbimet, dhe subvencionet dhe transferet shënuan vlerën prej 950.4 milionë euro që paraqet rritje prej 7.1 përqind krahasuar me vitin paraprak. Në kuadër të shpenzimeve rrjedhëse, shpenzimet qeveritare për subvencione dhe transferet kanë shënuar rritje vjetore prej 9.9 përqind, duke arritur në 317.8 milionë euro. Me rritje u

Figura 49. Struktura e shpenzimeve buxhetore, në milionë euro



Burimi: MF dhe kalkulimet e BQK-së (2014)

karakterizuan edhe shpenzimet qeveritare për mallra dhe shërbime si dhe shpenzimet qeveritare për paga dhe mëditje, që shënuan rritje prej 12.9 përkatësisht 2.3 përqind duke arritur në 215.6 përkatësisht 417.1 milionë euro.

Shpenzimet qeveritare për investime kapitale në vitin 2013 arritën vlerën prej 524.5 milionë euro që është për 3.1 përqind më pak se sa në vitin paraprak. Përkundër kësaj rënie, shpenzimet kapitale paraqesin kategorinë kryesore në kuadër të shpenzimeve buxhetore, me pjesëmarrje prej 35.7 përqind në gjithsej shpenzimet buxhetore (figura 49).


4.4.6 Sistemi Financiar

Sistemi financiar në Kosovë mbetet një ndër kontribuuesit më të rëndësishëm në stabilitetin e përgjithshëm makroekonomik në vend. Rritja e vazhdueshme e aktivitetit të sistemit financiar dhe zvogëlimi i rreziqeve që i kanosën këtij sistemi gjatë vitit 2013 u pasqyrua edhe në rritjen reale të ekonomisë së vendit. Gjithsej asetet e sistemit financiar arritën vlerën prej 4.2 miliard euro në vitin 2013, që përkon me një rritje vjetore prej 10.5 përqind. Rritja e aseteve të sistemit financiar kryesisht është mbështetur nga rritja e aseteve të fondeve pensionale dhe bankave komerciale gjatë kësaj periudhe, përderisa asetet e kompanive të sigurimit shënuan një rritje më të moderuar.

Segmenti kryesor në sistemin financiar në vend mbetet sektori bankar, asetet e të cilit përfaqësojnë rreth 72 përqind të totalit të aseteve të sistemit financiar dhe rreth 59 përqind të PBB-së. Sa i përket mbështetjes së sektorit privat të ekonomisë përmes kreditimit, raporti i gjithsej kredive të sektorit bankar ndaj PBB-së ishte rreth 35 përqind.


Aktiviteti kreditues i bankave u karakterizua me rritje në vitin 2013, megjithëse me ritëm më të ngadalëshëm të rritjes krahasuar me vitin paraprak. Në vitin 2013, gjithsej kreditë e sektorit bankar shënuan vlerën prej 1.81 miliard euro, që paraqet një rritje vjetore prej 2.4 përqind (3.8 përqind në vitin 2012). Ngadalësimi i ritmit të rritjes së kredive bankare është në përputhje me trendin e

Figura 50. Pesha e sektorit bankar në ndërmjetësimin financiar në vend, në milion euro




Burimi: BQK (2014)

Figura 51. Norma e rritjes së kredive sipas sektorëve, në përqindje



Burimi: BQK (2014)

Figura 52. Trendi i rritjes së kredive sipas sektorëve ekonomik, në përqindje




Burimi: BQK (2014)

shfaqur në eurozonë dhe në vendet e rajonit si rezultat i zhvillimeve ende sfiduese makroekonomike në nivel global. Trendi i ngadalësuar i rritjes së kreditimit që karakterizoi vitin 2013 mund ti atribuohet ofertës më të shtrënguar kredituese të bankave për ndërmarrjet, përderisa kërkesa për kredi ishte lehtësisht më e ulët si nga ndërmarrjet ashtu edhe nga ekonomitë familjare (figura 51). Sektori bankar ka vazhduar të mbështesë ndërmarrjet, përmes rritjes së vazhdueshme të kreditimit për pjesën më të madhe të sektorëve ekonomik në të cilët veprojnë. Sektorët ekonomik që siguruan mbështetjen më të madhe financiare nga sektori bankar në vitin 2013 ishin bujqësia, minierat, energjetika dhe shërbimet tjera (hoteliere dhe restorante, patundshmëri dhe qera, etj). Portfolio kreditore për sektorin e bujqësisë është rritur në vazhdimësi në vitet e fundit, sektor ky që është mbështetur edhe përmes subvencioneve të qeverisë për të nxitur aktivitetin bujqësor në Kosovë. Përderisa rritja e kreditimit për sektorin e minierave dhe energjetikës ndërlidhet me rritjen e aktivitetit ekonomik që kanë shënuar këta dy sektor, rritja e mbështetjes bankare për shërbimet tjera mund të jetë rezultat i fokusimit të investimeve në këto dy industri nga investitorët privat (vendor dhe të huaj). Në vitin 2013, sektori bankar në vend zvogëloi kreditimin e sektorëve të prodhimitarisë dhe ndërtimitarisë, që mund të reflektoj deri në një masë ngadalësim të aktivitetit në këta dy sektor ekonomik.

Normat mesatare të interesit në kredi dhe depozita u karakterizuan me një tendencë rënëse gjatë vitit 2013. Norma mesatare e interesit në kredi u zvogëlu në 12.4 përqind (13.4 përqind në vitin 2012), ndërkaq ajo e depozitave u zvogëlu në 3.4 përqind (3.6 përqind në vitin 2012). Rrjedhimisht, dallimi në mes të normave të interesit në kredi dhe depozita në 2013 u ngushtua në 9 pp, krahasuar me 9.8 pp në 2012 (figura 54). Në linjë me pritjet e bankave komerciale të deklaruar në anketën për kreditimin bankar për vitin 2014, vazhdimi i politikave më të lehtësuara kredituese nga bankat përmes zvogëlimit të mëtejme të kostos së financimit pritet të kenë ndikim direkt në rritjen e aktivitetit kreditues duke u përkthyer si rrjedhojë në rritje të konsumit dhe investimeve.


Depozitat e sektorit bankar vazhduan rritjen edhe në vitin 2013, dhe mbesin burimi kryesor i financimit të aktivitetit bankar. Në vitin 2013, depozitat e sistemit bankar përfaqësonin 80.1 përqind të gjithsej detyrimeve dhe arritën vlerën prej 2.45 miliard euro. Në rritjen e depozitave të sektorit bankar kontribuuan rritja e depozitave të ekonomive familjare, që njëherësh kanë edhe pjesëmarrjen më të lartë në strukturën e gjithsej depozitave (72.5 përqind), si dhe depozitat e ndërmarrjeve (22.7 përqind të gjithsej depozitave). Rritja e depozitave të ekonomive familjare gjatë vitit 2013 mund ti atribuohet pjesërisht rritjes së burimeve të financimit të ekonomive familjare gjatë kësaj periudhe (për shembull. remitencat, kompenzimi i punëtorëve nga jashtë, etj.), përderisa rritja e depozitave të

Figura 53. Mesatarja vjetore e normave të interesit, në përqindje



Burimi: BQK (2014)

Figura 54. Treguesit e profitabilitetit




Burimi: BQK (2014)

ndërmarrjeve gjatë kësaj periudhe mund t'i atribuohet deri në një masë ngadalësimit të aktivitetit ekonomik të disa ndërmarrjeve. Sipas afatit të maturimit, në kuadër të depozitave të afatizuara vazhdojnë të dominojnë depozitat me afat më të shkurtër maturimi prej 'deri në një vit' (62.1 përqind). Vlen të theksohet se mbështetja në burime afatshkurtra të financimit nga sektori bankar pengon rritjen e kreditimit afatgjatë, gjë që vlerësohet të jetë shumë i nevojshëm për ekonominë e vendit.

Performanca e sektorit bankar shënoi përmirësim gjatë vitit 2013. Fitimi neto i sektorit bankar shënoi rritje vjetore prej 40.7 përqind në vitin 2013, duke arritur vlerën 26 milionë euro (figura 55).

Stabiliteti i sektorit bankar vazhdon të kontribuoj në stabilitetin e përgjithshëm makroekonomik në vend. Edhe në vitin 2013, treguesit kyç të likuiditetit u karakterizuan me rritje, duke ndikuar në përmirësimin e pozitës së likuiditetit të sektorit bankar. Gjithashtu, sektori bankar është karakterizuar në vazhdimësi me nivel të lartë të kapitalizimit i cili ka kaluar kërkesat minimale rregullative. Gjatë vitit 2013, ekspozimi ndaj rrezikut kreditor është rritur, ku raporti i Kredive Joperformuese (angl. Non-Performing Loans: NPL) ndaj gjithsej kredive në dhjetor 2013 arriti në 8.7 përqind (7.5 përqind në 2012). Sidoqoftë, kreditë joperformuese mbesin mirë të mbuluara me provizione (110.6 përqind), gjë që e relativizon ekspozimin e sektorit ndaj rrezikut kreditor (figura 55). Ndërsa ekspozimi i sektorit bankar ndaj rrezikut të tregut, që nënkupton rrezikun nga lëvizjet e kursit të këmbimit valutor si dhe ndryshimet në normat e interesit ka shënuar rënie në vitin 2013.

Figura 55. NPL-të dhe provizionet



Burimi: BQK (2014)


5. Pritjet e bankave mbi aktivitetin kreditor

Pritjet e bankave për zhvillimet potenciale në kërkesën për kredi në gjashtëmujorin e dytë të vitit 2014 tregojnë se përgjithësisht, për rritje të kërkesës për kredi nga dy kategoritë, ndërmarrjet dhe ekonomitë familjare.

Në gjashtëmujorin e dytë të vitit 2014, bankat komerciale në vend kanë deklaruar se presin rritje të kërkesës për kredi nga të gjitha kategoritë e ndërmarrjeve. Rritje më të madhe të kërkesës për kredi bankat presin nga ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, ndërsa sa i përket maturitetit, pritjet janë se kërkesa do të rritet kryesisht për kredi afatshkurtëra. Zhvillimet në trendin e kreditimit të ndërmarrjeve në gjashtëmujorin e parë të vitit 2014 krahasuar me gjashtëmujorin e dytë të vitit 2013 tregojnë për një përshejtim të ritmit të rritjes së kreditimit të ndërmarrjeve, përshejtim ky i cili ishte në linjë me pritjet e bankave për këtë periudhë (Figura 56).


Pritjet e bankave mbasin optimiste sa i përket rritjes së kërkesës për kredi nga ekonomitë familjare gjatë gjysmës së dytë të vitit 2014. Bankat kanë deklaruar se presin rritje të kërkesës për kredi gjatë gjashtëmujorit të dytë të vitit 2014 për të dy kategoritë, kreditë për blerje të shtëpive dhe kreditë konsumuese. Të dhënat për zhvillimet në ofertën kredituese të bankave për ekonomitë familjare në gjashtëmujorin e parë të vitit 2014 tregojnë për përshejtim të ritmit të rritjes së gjithsej kredive për ekonomitë familjare në gjashtëmujorin e parë të vitit 2014 krahasuar me rritjen e shënuar në gjashtëmujorin e dytë të vitit 2013. (Figura 57).

Figura 56. Pritjet e bankave mbi kerkesen per kredi nga ndermarrjet dhe rritja e kredive ndaj ndermarrjeve



*Që nga viti 2014, anketa realizohet për periudhën gjashtë mujore. Burimi: BQK (2014)

Figura 57. Pritjet e bankave mbi kerkesen per kredi konsumuese dhe hipotekare dhe rritja e kredive ndaj ekonomive familjare



Shënim: Që nga viti 2014, anketa realizohet për periudhën gjashtë mujore. Burimi: BQK (2014)

6. Parashikimet mbi treguesit kryesor makroekonomik

Rritja ekonomike për vitin 2014 pritet të përshpejtohet në krahasim me vitin paraprak. Faktor kryesor në përshpejtim të rritjes ekonomike për vitin 2014 pritet të jetë komponenta e konsumit privat, ndërsa me efekt pozitiv pritet të jetë edhe konsumi publik. Sa i përket investimeve, efekti i tyre pritet të jetë neutral. Përkundër performancës pozitive të investimeve private, rënia e investimeve publike pritet të eliminojë efektin e investimeve private në rritje. Me ndikim negativ në rritje pritet të jetë deficitit tregtar në mallra dhe shërbime i cili gjatë vitit 2014 pritet të përkeqësohet. Parashikimet e BQK-së sugjerojnë se norma reale e rritjes së PBB-së për vitin 2014 do të jetë 3.7 përqind.

Sektori bankar gjatë vitit 2014 pritet të zgjerohet më tutje aktivitetin e tij nëpërmjet rritjes së përshpejtuar të kredive. Gjithsej kreditë e sektorit bankar pritet të shënojnë një normë vjetore të rritjes prej rreth 5 përqind në vitin 2014, krahasuar me rritjen prej 2.4 përqind në vitin 2013. Depozitat e sektorit privat gjatë vitit 2014 pritet të vazhdojnë trendin e rritjes që i ka karakterizuar në vitet e fundit. Rritja e depozitave të sektorit privat gjatë viti 2014 pritet të jetë 7.3 përqind.

Gjatë vitit 2014, sektori fiskal parashihet të karakterizohet me rritje të të hyrave buxhetore prej 1.8 përqind dhe rritje të shpenzimeve buxhetore prej 4.0 përqind. Si rezultat, deficitit primar buxhetor pritet të rritet për 23.2 përqind dhe të arrijë në 188.1 milionë euro ose 3.0 përqind e PBB-së.

Në vitin 2014, sektori i jashtëm pritet të karakterizohet me rritje të deficitit të llogarisë rrjedhëse, si rezultat i pritjeve për rritje të importit prej rreth 1.5 përqind si dhe parashikimeve për nivel të ngjashëm të eksporteve krahasuar me vitin paraprak. Deficitit i llogarisë rrjedhëse pritet të arrijë në 453.6 milionë euro, që është për 33.6 përqind më i lartë se sa deficitit i shënuar në vitin paraprak. Ndërsa, suficiti i llogarisë kapitale dhe financiare pritet të arrijë në 271.0 milionë euro apo 60.7 përqind më i lartë se sa suficiti i shënuar në vitin paraprak.

Ecuria e çmimeve gjatë vitit 2014 pritet të karakterizohet me stabilitet si rezultat i rritjes modeste të çmimeve. Parashikimet janë se norma e inflacionit për vitin 2014 do të jetë rreth 1.0 përqind. Ky nivel i inflacionit pritet të jetë si rezultat i trendit rënës në nivel global të çmimeve në produktet kryesore, sidomos atyre që Kosova importon më shumë si nafta dhe produktet ushqimore. Gjithashtu edhe zhvillimet e brendshme, si ulja e çmimit të disa kategorive të çmimeve të administruara (p.sh. edukimi) pritet të kontribuojë që inflacioni të jetë i moderuar. Në anën tjetër, çmimet në sektorët e pa-tregtueshme mund të rriten si rezultat i rritjes së pagave në sektorin publik, ndërsa inflacioni mund të ndikohet edhe nga rritja e çmimeve të energjisë elektrike.


6.1. Produkti i brendshëm bruto

Parashikimet makroekonomike për ekonominë e Kosovës gjatë vitit 2014 sugjerojnë se aktiviteti ekonomik do të të rritet me ritëm më të shpejtë në krahasim me vitin 2013. Parashikimet e BQK-së sugjerojnë se norma e rritjes reale të PBB-së gjatë vitit 2014 do të arrijë në 3.7 përqind. Parashikimet e marsit 2014 ishin se rritja do të jetë 4.0 përqind, mirëpo, si rezultat i performancës më të dobët të disa sektorëve të ekonomisë, norma e rritjes është reviduar. Performancë më të dobët gjatë vitit 2014 ka pasur sektori fiskal dhe sektori i jashtëm që kanë përkeqësuar treguesit mbi investimet publike por edhe në neto eksporte. Ndërsa, në masë të madhe këto zhvillime janë neutralizuar nga zhvillimet më të shpejta pozitive në sektorin financiar dhe rritjen e pagave për shërbyesit civil, që kanë përforcuar konsumin, por edhe investimet private (Figura 59). Rrjedhimisht, gjatë vitit 2014, rritja ekonomike ka vazhduar të gjenerohet nga kërkesa e brendshme. Kontribues kryesor pritet të jetë konsumi privat dhe konsumi publik. Në anën tjetër, investimet pritet të jenë po thuaj se me efekt neutral, të nxitura nga rënia e investimeve publike por edhe rritja e dobët e investimeve private. Kërkesa e jashtme apo neto eksportet për vitin 2014 pritet të kontribuojnë negativisht (Figura 59).

Siç edhe janë paraqitur në figurën 59, komponenta e konsumit pritet që gjatë vitit 2014 të jetë bartëse e rritjes ekonomike e nxitur si nga konsumi privat ashtu edhe nga konsumi publik. Konsumi gjatë vitit 2014 pritet të rritet me 4.1 përqind në terma real, bazuar në pritjet që konsumi privat do të rritet me 3.7 përqind, dhe konsumit publik do të rritet me 6.1 përqind. Faktorët kryesor që pritet të ndikojnë në rritjen e konsumit gjatë kësaj periudhe pritet të jenë rritja e pagave dhe mëditjeve për shërbyesit civil, rritja e remitencave si dhe rritja e kredive konsumuese.


Sa i përket investimeve, gjatë vitit 2014 ato pritet të karakterizohen me rënie reale prej 0.9 përqind dhe të kontribuojnë negativisht në rritje të PBB-së me 0.2 pikë përqindje. Gjatë vitit 2014 investimet pritet të shënojnë rënie si rezultat i mos implementimit të një pjese të projekteve kapitale nga sektori publik. Investimeve publike gjatë vitit 2014, në terma real, pritet të zvogëlohen për 9.3 përqind. Në anën tjetër, komponenta e investimeve private pritet të rritet si rezultat i përshpejtimit të theksuar të aktivitetit kreditor, sidomos kredive për investime, nga sektori financiar në vend. Rrjedhimisht, rritja reale e investimeve private pritet të jetë 3.8 përqind.

Figura 58. Rritja reale e PBB-së, kërkesa e brendshme dhe e jashtme, në përqindje



Burimi: ASK (2014). (f) Projeksione të BQK-së

Figura 59. Rritja reale e PBB-së dhe kontribuesit në rritje, në përqindje



Burimi: ASK (2014). (f) Projeksione të BQK-së


Neto eksportet e mallrave dhe shërbimeve gjatë vitit 2014 pritet të kontribuojnë negativisht në rritjen e PBB-së me 0.4 pikë përqindje si rezultat i rritjes më të shpejtë të importeve kundrejt eksporteve në kuadër të mallrave. Në anën tjetër, pozicioni tregtar në kuadër të shërbimeve pritet se do të vazhdojë të jetë pozitiv edhe gjatë vitit 2014. Në kuadër të mallrave, parashikimet aktuale janë se eksportet do të mbajnë nivel pothuajse të ngjashëm me vitin paraprak, ndërsa importet do të rriten lehtë. Sa i përket shërbimeve, eksporti i tyre pritet të rritet më shpejt se sa importi.

6.2. Sektori bankar

Pas disa viteve me ngadalësim të vazhdueshëm të kreditimit, në vitin 2014 pritet që kreditimi nga sektori bankar të rritet me normë të përshpejtuar, duke shënuar një normë vjetore të rritjes prej rreth 5 përqind, krahasuar me rritjen prej 2.4 përqind në vitin 2013. Rritja e kreditimit pritet të jetë më e shpejtë për ekonomitë familjare, por trendi rritës do të përcjellë edhe kreditë ndaj ndërmarrjeve. Përveç përmirësimit të ambientit të përgjithshëm në vend, faktorë tjetër me rëndësi që pritet të ndikojnë në rritjen e mëtejme të kreditimit është edhe rritja e kapacitetit të ekonomive familjare për huamarrje dhe forcimi i aftësisë së tyre paguese si rezultat i rritjes së pagave nga sektori publik. Parashikimet e BQK-së për rritje të kreditimit janë gjithashtu në linjë me raportimet e bankave në kuadër të anketës së kreditimit bankar e cila parashih përshpejtim të aktivitetit kreditor gjatë periudhave në vazhdim (figura 60 dhe 61). Me gjithë rritjen e përshpejtuar të kredisë, sistemi bankar pritet të mbajë edhe më tej nivel të kënaqshëm të likuiditetit dhe treguesve tjerë të shëndetshmërisë financiare në vend. Përshepjtimi i rritjes së kreditimit konvergjon me zhvillimet në sektorin real të ekonomisë, marrë parasysh reflektimin e konsiderueshëm të aktivitetit kreditor dhe sjelljen e tijë pro-ciklike në krahasim me rritjen e PBB-së (figura 61). Kjo sjellje pro-ciklike vjen si rezultat i rritjes së kërkesës së përgjithshme në vend (PBB-së) dhe rrjedhimisht, rritjes së kërkesës për kredi, që reflekton edhe në nivel më të ulët të rrezikut të perceptuar nga bankat.


Depozitat e sektorit privat gjatë vitit 2014 pritet të vazhdojnë trendin e rritjes që i ka karakterizuar në vitet e fundit. Rritja e depozitave të sektorit privat gjatë viti 2014 pritet të jetë 7.3 përqind krahasuar me 8.0 përqind në vitin 2013. Për dallim nga kreditë, të cilat karakterizohen me sjellje pro-ciklike, depozitat në anën tjetër kanë më tepër sjellje kundër-ciklike pasi që në kohët kur ekonomia është rritur më shpejtë, depozitat kanë treguar shenja të ngadalësimit. Kjo sjellje e depozitave mund të jetë rezultat i faktit se gjatë kohëve të aktivitetit

Figura 60. Rritja e kreditimit dhe rritja reale e PBB-së



Burimi: ASK (2013) BQK (2014), (e) vlerësim (f) projektion i BQK-së (2014)

Figura 61. Rritja e kreditimit dhe rritja reale e PBB-së



Burimi: ASK (2013) BQK (2014), (e) vlerësim (f) projektion i BQK-së (2014)

më të madh ekonomik, individët dhe bizneset mund të jenë më të prirur të shpenzojnë/investojnë, duke bërë që ritmi i rrjedhjes së depozitave në sektorin bankar të ngadalësohet.


6.3. Sektori fiskal

Gjatë vitit 2014 sektori fiskal parashihet të karakterizohet me rritje të të hyrave buxhetore prej 1.8 përqind dhe rritje të shpenzimeve buxhetore prej 4.0 përqind. Rrjedhimisht, deficitin primar buxhetor pritet të rritet për 23.2 përqind dhe të arrijë në 188.1 milionë euro (figura 62). Në raport me PBB-në, deficitin primar parashihet të arrijë normën prej 3.0 përqind krahasuar me normën prej 2.9 përqind në vitin paraprak.

6.3.1 Të hyrat buxhetore

Të hyrat primare gjatë vitit 2014 pritet të arrijnë në 1.34 miliardë euro apo 1.8 përqind më shumë se sa viti paraprak. Në raport me PBB-në, të hyrat buxhetore pritet të kenë nivel pothuajse të njëjtë me vitin paraprak (24.4 përqind e PBB-së). Kjo rritje e të hyrave buxhetore pritet të jetë rezultat i rritjes së aktivitetit ekonomik, por edhe vazhdimit të luftimit të ekonomisë joformale. Rritja e aktivitetit ekonomik pritet të jetë e mbështetur kryesisht në rritjen e konsumit që, mes tjerash, është nxitur edhe nga rritja e pagave dhe pensione. Rritja e konsumit së bashku me rritjen e importit pritet të ndikojnë në arkëtim më të madh të të hyrave buxhetore.

Figura 62. Të hyrat dhe shpenzimet primare buxhetore, në milionë euro



Burimi: MF (2014). (f) Projektione të BQK-së

6.3.2 Shpenzimet buxhetore

Shpenzimet primare buxhetore gjatë vitit 2014 pritet të arrijnë në 1.53 miliardë euro apo 4.0 përqind më shumë se sa viti paraprak. Si përqindje e PBB-së edhe shpenzimet buxhetore sikurse të hyrat buxhetore pritet të kenë nivel pothuajse të njëjtë me vitin paraprak (27.3 përqind). Gjatë vitit 2014 pritet të ketë ndryshim të konsiderueshëm në strukturën e shpenzimeve buxhetore. Shpenzimet rrjedhëse parashihet të rrisin pjesëmarrjen në gjithsej shpenzimet nga 64.7 përqind sa ishte në vitin 2013 në 68.5 përqind në vitin 2014. Kjo rritje e pjesëmarrjes së shpenzimeve rrjedhëse në gjithsej shpenzimet i atribuohet kryesisht rritjes së kategorisë së pagave dhe mëditjeve e cila ka pjesëmarrjen më të madhe në kuadër të shpenzimeve rrjedhëse. Në anën tjetër, shpenzimet kapitale pritet të zvogëlojnë pjesëmarrjen në gjithsej shpenzimet nga 35.7 përqind në vitin 2013 në 31.5 përqind të gjithsej shpenzimeve. Edhe vonesat në konsolidimin e institucioneve pritet të kenë efekt negativ në egzekutimin e shpenzimeve në përgjithësi.

6.3.3 Financimi

Përveç shpenzimeve të lartcekura, pritet që shpenzimet neto në emër interesit për borxhin publik (të brendshëm dhe të jashtëm) të arrijnë në 17.3 milionë euro. Kjo do të bëjë që bilanci i përgjithshëm buxhetor i qeverisë të arrijë deficitin prej 205.5 milionë euro apo 41.3 milionë euro më shumë se sa viti i kaluar. Financimi i deficitit të përgjithshëm pritet të bëhet kryesisht nga huazimi i brendshëm dhe të hyrat e privatizimit, të cilat pritet të arrijnë shumën prej 132.4 milionë euro ndërsa pjesa tjetër pritet të financohet duke zvogëluar bilancin bankar. Sa i përket borxhit të jashtëm publik, gjatë vitit 2014 pritet që qeveria të shlyejë rreth 21.9 milionë euro

borxh ndaj kreditorëve të ndryshëm, ndërsa kreditë e reja duke përfshirë edhe financimin zyrtar, pritet të jenë rreth 7.6 milionë euro.

6.4. Sektori i jashtëm


Në vitin 2014, sektori i jashtëm pritet të karakterizohet me rritje të deficitit të llogarisë rrjedhëse. Deficiti i llogarisë rrjedhëse pritet të arrijë në 453.6 milionë euro (figura 63), që është për 33.6 përqind më i lartë se sa deficitin e shënuar në vitin paraprak. Ndërsa, suficiti i llogarisë kapitale dhe financiare pritet të arrijë në 271.0 milionë euro apo 60.7 përqind më i lartë se sa suficiti i shënuar në vitin paraprak.

Përderisa në vitin 2013 ishte shënuar një rënie e deficitit të llogarisë rrjedhëse nga 7.5 përqind e PBB-së në 6.4 përqind të PBB-së, në vitin 2014 pritet që deficitin e llogarisë rrjedhëse të arrijë në 8.1 përqind të PBB-së. Eksporti i mallrave pritet të arrijë nivelin prej 307.5 milionë euro që paraqet një rritje të lehtë prej 0.8 përqind. Performanca e dobët e eksporteve i adresohen kryesisht rënies së konsiderueshme të çmimeve të metaleve gjatë vitit 2014. Importi i mallrave pritet të arrijë në 2.33 miliardë euro apo 1.5 përqind më shumë se sa në vitin e kaluar (figura 64). Përkeqësimi i bilancit të mallrave prej 1.6 përqind pritet të zbutet në masë të konsiderueshme nga eksporti i shërbimeve i cili pritet të arrijë në 654.2 milionë euro që paraqet një rritje prej 5.2 përqind, ndërkohë që importi i shërbimeve prej 326.0 milionë euro pritet të shënojë rritje të ngadalësuar (nga 8.6 përqind në vitin 2013 në 3.9 përqind në vitin 2014). Eksporti i shërbimeve pritet të gjenerohet kryesisht nga rritja e eksportit të shërbimeve të udhëtimit që ndërlikohet me shpenzimet e emigrantëve në Kosovë, ndërsa rritja e importit të shërbimeve pritet të gjenerohet nga rritja e importit të shërbimeve të transportit, udhëtimit dhe shërbimeve ndërtimore. Bilanci i mallrave dhe shërbimeve pritet të shënojë deficit tregtar prej 1.70 miliardë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 0.7 përqind.

Importi pritet të shënojë rritje për faktin se konsumi pritet të jetë gjeneruesi kryesor i rritjes ekonomike në vitin 2014, i cili përveç prodhimeve vendore pritet të mbulohet edhe nga importi. Megjithatë, rritja e vlerës së importit mund të neutralizohet paksa ngase pritet që çmimet e naftës të shënojnë rënie në tregjet ndërkombëtare. Në anën tjetër, rënia e eksportit të mallrave prej 5.2 përqind deri në qershor është shkaktuar kryesisht nga rënia e çmimeve të metaleve prej 8.4 përqind, ndërkohë tani kjo rënie e çmimeve të metaleve është ndërprerë dhe në pjesën tjetër të vitit pritet të shënojë rritje prej 1.0 përqind dhe, rrjedhimisht, edhe eksporti i mallrave pritet të shënojë një ngritje të lehtë prej 0.8 përqind.


Importi pritet të shënojë rritje për faktin se konsumi pritet të jetë gjeneruesi kryesor i rritjes ekonomike në vitin 2014, i cili përveç prodhimeve vendore pritet të mbulohet edhe nga importi. Megjithatë, rritja e vlerës së importit mund të neutralizohet paksa ngase pritet që çmimet e naftës të shënojnë rënie në tregjet ndërkombëtare. Në anën tjetër, rënia e eksportit të mallrave prej 5.2 përqind deri në qershor është shkaktuar kryesisht nga rënia e çmimeve të metaleve prej 8.4 përqind, ndërkohë tani kjo rënie e çmimeve të metaleve është ndërprerë dhe në pjesën tjetër të vitit pritet të shënojë rritje prej 1.0 përqind dhe, rrjedhimisht, edhe eksporti i mallrave pritet të shënojë një ngritje të lehtë prej 0.8 përqind.

Figura 63. Llogaria rrjedhëse, në milionë euro



Burimi: BQK (2014). (f) Projektion

Figura 64. Eksporti dhe importi i mallrave, në milionë euro



Burimi: BQK (2014). (f) Projektion

Bilanci i llogarisë së transfereve në vitin 2014 pritet të shënojë suficit prej 1.12 miliardë euro që është për 8.6 përqind më i ulët se sa suficiti i shënuar në vitin paraprak. Ky zvogëlim i suficitit i atribuohet kryesisht zvogëlimit të transfereve zyrtare¹² për 31.5 përqind. Në anën tjetër, transferet tjera private pritet të shënojë rritje neto prej 0.3 përqind. Në kuadër të transfereve private përfshihen edhe remitencat të cilat pritet të shënojë rritje vjetore prej 3.0 përqind, të nxitura kryesisht nga zhvillimet pozitive në ekonomitë si Gjermania dhe Zvicra, ku diaspora kosovare është më e koncentruar.

Bilanci i llogarisë kapitale dhe financiare pritet të arrijë nivelin prej 271.0 milionë euro apo 60.7 përqind më shumë se bilanci i kësaj llogarie në vitin paraprak. IHD-të pritet të mbesin komponenta kryesore e cila për vitin 2014 është parashikuar të ketë nivel relativisht të ngjashëm me vitin paraprak.

¹² Transferet zyrtare përfshinë pagat e donatorëve dhe grantet e përcaktuara të donatorëve.

7. Shtojca statistikore

Tabela 1. Treguesit Kryesor Makroekonomik

Përshkrimi	2010	2011	2012	2013	2014 (f)
	<i>Në milionë euro (vlera nominale)</i>				
Produkti i Brendshëm Bruto (PBB)/1	4401.9	4814.6	5058.8	5326.6	5590.6
Konsumi	4516.5	4975.5	5320.4	5539.4	5823.1
Investimet	1450.6	1632.4	1465.1	1470.9	1463.4
Neto Eksportet	-1565.2	-1793.3	-1726.7	-1683.7	-1696.0
	<i>Ndryshimi në përqindje, në terma real</i>				
Rritja reale e PBB-së/1	3.3	4.4	2.8	3.4	3.7
Konsumi	2.5	3.0	2.6	2.2	4.1
Investimet	10.9	7.9	-12.9	-0.3	-0.9
Neto Eksportet	7.5	3.7	-12.1	-3.6	1.1
	<i>Në milionë euro (vlera nominale)</i>				
Llogaria Rrjedhëse/2	-515.2	-659.3	-378.4	-339.4	-453.6
Importi i Mallrave	-2057.1	-2383.9	-2359.8	-2297.1	-2331.7
Eksporti i Mallrave	305.0	324.9	286.9	305.1	307.5
Importi i Shërbimeve	-386.1	-352.8	-288.8	-313.7	-326.0
Eksporti i Shërbimeve	573.0	618.5	635.1	622.0	654.2
Remitencat/2	584.3	584.8	605.1	620.8	639.4
	<i>Në milionë euro (vlera nominale)</i>				
Gjithsej kreditë e sektorit bankar për sektorin privat/2	1456.1	1690.8	1756.5	1799.7	1891.7
Gjithsej depozitat në sektorin bankar/2	1936.8	2104.0	2279.1	2449.0	2615.0
	<i>Në milionë euro (vlera nominale)</i>				
Buxheti i Kosovës/3					
Gjithsej të hyrat primare	1128.5	1283.3	1284.3	1316.2	1338.3
Gjithsej shpenzimet primare	1264.7	1382.2	1441.0	1468.9	1527.4
Deficiti primar	-98.7	-73.0	-119.3	-152.7	-188.1
	<i>Ndryshimi në përqindje</i>				
Rritja ekonomike reale/4					
Globale	5.2	3.9	3.2	3.0	3.6
Eurozona	2.0	1.6	-0.7	-0.5	1.2
Vendet në zhvillim të Evropës	4.7	5.4	1.4	2.8	2.4

1/ Agjensia Statistike e Kosovës për vitet 2010-2013

2/ Banka Qendrore e Republikës së Kosovës për vitet 2010-2013

3/ Ministria e Financave për vitet 2010-2013

4/ Fondi Monetar Ndërkombëtar për vitet 2010-2014

(f) Parashikim

Pjesët e hijezuara paraqesin vlerësime dhe parashikime të BQK-së

Tabela 2.1. Bilanci i pagesave, komponentët kryesorë

(Në milionë euro)

Përshkrimi	Logaria rrjedhëse						Logaria kapitale dhe financiare			Gabimet dhe harrësat neto
	Mallrat dhe shërbimet				Të hyrat	Transferet rrjedhëse	Logaria kapitale	Logaria financiare		
	Mallrat	Shërbimet								
